



Buletini i Shkencave Gjeologjike
1/2023

Bulletin of Geological Sciences

BORDI EDITORIAL

DR. SOKOL MARKU - KRYEREDAKTOR
DR. MADALINA ELENA KALLANXHI - SEKRETAR
PROF. ASS. DR. VEIP GJONI - ANËTAR
DR. ALTIN KARRIQI - ANËTAR
PROF. DR. IRAKLI PRIFTI - ANËTAR
PROF. DR. KUJTIM ONUZI - ANËTAR
DR. ANDREEA UTA - ANËTAR

ING. ELISA PRENDI - REDAKTORE PËRGJEGJËSE

ISSN 0254-5276

Evolutioni i studimeve të nanofosileve gëlqerore në Shqipëri [Evolution of calcareous nannofossil studies in Albania]	
Mădălina – Elena Kallanxhi	3 [15]
Veçoritë fiziko-kimike, origjina dhe ndryshimet kimike të burimeve termale në Llixha, Elbasan [Physical – chemical properties, origin and chemical changes in the thermal springs from Llixha, Elbasan]	
Dhori Dapi, Aurela Jahja, Julinda Sulejmani, Irida Çela	27 [41]
Aplikimi i përcaktimeve pirolitike dhe gaskromatografike në pusin Fortuzaj-2 [Application of pyrolytic and gas chromatographic determinations in Fortuzaj-2 borehole]	
Enkela Noçka, Ilva Gjika, Gjon Rrota	55 [67]
Studim paraprak për një modelim 3d të tektonikave shkëputëse [Preliminary study for a 3d modeling of the detachment faults]	
Sokol Marku, Anxhela Dervishi, Iba Çausi	79 [91]
Vlerësimi fillestar i gjeomorfositeve në bashkinë Pogradec nëpër- mjet metodologjisë GAM [Preliminary assessment of the geomorphosites from the Pogra- dec municipality using the GAM methodology]	
Ermiona Braholl, Oksana Kreka	103 [117]
<i>In memoriam</i>	
Në nderim e kujtim të Prof. Dr. Andon Grazhdani	
Prof. Dr. Vasil Jorgji	i
Në nderim e kujtim të Prof. Dr. Fotaq Diamanti	
Prof. Dr. Afat Serjani	iii
Në nderim e kujtim të Prof. Dr. Kristaq Muska	
Prof. Dr. Vasil Jorgji	v

EVOLUCIONI I STUDIMEVE TË NANOFOSILEVE GËLQERORE NË SHQIPËRI

MĂDĂLINA – ELENA KALLANXHI^{1*}

¹Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Rruga Zef Serembe, Tiranë, Shqipëri

*Autori korrespondent: madalina_kallanxhi@yahoo.com

(Dorëshkrim i dorëzuar në gusht 2023; i pranuar për botim në nëntor 2023)

ABSTRAKT

Nanofosilet gëlqerore janë mbetje gëlqerore që i përkasin algave Haptophyte dhe përfaqësojnë një nga grupet më të përhapura në oqeanet aktuale dhe në të dhënat fosile. Për shkak të bollëkut të tyre të lartë dhe përdorimit të lehtë të tyre, nanofosilet janë një mjet i mirë për biostratigrafinë, kërkimin e hidrokarbureve dhe kërkimin shkencor. Ky punim paraqet evolucionin e studimeve të nanofosileve gëlqerore në Shqipëri, duke nisur që nga përfshirja e tyre si një metodë e re mikropaleontologjike nga Instituti i Naftës dhe Gazit Fier në vitin 1982. Studimi i nanofosileve gëlqerore shtrihet në një interval prej rreth 16 vitesh dhe ka qenë një nga shtyllat kryesore në fushën e kërkimit të hidrokarbureve në atë kohë. Ky dorëshkrim nxjerr në pah rezultatet më të rëndësishme të arritura në biostratigrafinë e nanofosileve gëlqerore, duke filluar nga viti 1982 e deri më sot. Zonat që kanë qenë subjekt i punimeve kërkimore kanë qenë Ultësira Adriatike dhe Zona Jonike, nga ku u përshkruan disa biozona që i përkasin erës Kenozoike. Studimet më të fundit mbi sedimentet molasike të Ultësirës Shqiptaro – Thessaliane përmirësojnë kuadrin e përgjithshëm biostratigrafik dhe nxjerrin të dhëna të reja mbi paleoekologjinë dhe paleomjedisin e nanofosileve gëlqerore.

Fjalë kyçe: historiku i nanofosileve gëlqerore, biostratigrafi, mikropaleontologji, Shqipëri.

HYRJE

Studimi i nanofosileve gëlqerore është një degë e rëndësishme shkencore në mikropaleontologji dhe biostratigrafi, dhe ka zbatueshmëri në industrinë e hidrokarbureve dhe gazit. Rëndësia e tyre biostratigrafike u vu re dhe u bë e njohur për herë të parë rreth vitit 1950 dhe filloi me studime të ndryshme të depozitimeve Kenozoike (Bown & Young 1998).

Grupi i nanofosileve gëlqerorë shtrihet në një hapësirë kohore nga Triasiku i vonshëm deri në kohët e sotme, dhe përfshin mikrofosilet e përbëra prej karbonatit të kalciumit, me madhësi më të vogël se 63 µm (mikron), duke përfshirë copat dhe format e fosileve të reja. Si grup i përkasin Coccolithophoreve (ndarja Haptophyta; Lohmann 1902), dhe sipas morfologjisë, mënyrës së formimit dhe fazave të cikleve jetësore, mund

të ndahen në: heterokokolitë, holokokolitë dhe nanolite (Braarud et al. 1955a, 1955b.; Young et al. 1994, 1999). Ky grup shfaq një shpërndarje biogeografike më të larmishme në gjerësitë e ulëta, ndërsa nuk gjendet mbi 70° në gjerësitë më të larta. Ato mund të gjenden në mjedise eutrofike, mezotrofike dhe oligotrofike dhe shpërndarja e tyre në mbarë botën lidhet me temperaturën e ujit të detit, shpërndarjen e lëndëve ushqyese, qarkullimin e rrymave oqeanike, rrymat e fundit oqeanike dhe përzierjen sezonale të shtresave të ujit, kripësinë dhe përmbytjen e karbonateve në ujë etj.

Gjatë dekadave të fundit, janë mbledhur të dhëna të rëndësishme që kanë të bëjnë me depozitimet tokësore dhe oqeanike nga e gjithë bota dhe janë përpiluar dhe përmirë-

¹Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Tiranë
Email: madalina_kallanxhi@yahoo.com

suar disa skema biostratigrafike, si për epokën Mesozoike ashtu edhe për atë Kenozoike. Biostratigrafia me bazë nanofosile gëlqerore, sot për sot është përmirësuar me futjen dhe mbështetjen e metodave të ndryshme, si: magnetostratigrafia, ciklostratigrafia, stratigrafia izotopike dhe krahasimi me grupe të tjera mikrofosile. Bashkërendimi i të gjitha këtyre metodave dhe të dhënave lejojnë një biokronologji dhe një saktësim më të mirë të ngjarjeve të nanofosileve gëlqerore.

Qëllimi i këtij artikulli është të nxjerrë në pah njohuritë që janë mbi këtë tematikë në Shqipëri, që në fillimet e saj, për të vënë në dukje rëndësinë e nanofosileve gëlqerore në industrinë

e hidrokarbureve dhe në veprimtari që lidhen me hartografinë, sedimentologjinë dhe stratigrafinë.

NDËRTIMI GJEOLGJIK

Studimet e nanofosileve gëlqerore në Shqipëri shtrihen në një interval prej rreth 16 vite dhe janë iniciuar në kuadër të kërkimit të naftës dhe gazit nga Instituti i Naftës dhe Gazit Fier (Shqipëri), gjatë viteve '80. Këto hulumtime u përqendruan kryesisht në depozitimet terrigjene (flihi dhe molasa) të Zonës Jonike dhe Ultësira Adriatike (Fig. 1), dhe më pak në zonat e tjera tektonike si: Mirdita, Kruja, Sazani, Krastë – Cukali dhe Ultësira Shqiptare – Thesalliane.




Figura 1. Studimet e nanofosileve gëlqerore në Shqipëri dhe vendodhja e tyre në hartën gjeologjike (e rivizituar sipas Xhomo et al. 2002). 1 - Islami (1982; në Dalipi et al. 1985; Tortonian); 2 - Islami & Prençi (1983; në Çobo 1989; Langhian deri në Tortonian); 3 - Islami & Çobo (1984; në Çobo 1989; Langhian – Tortonian); 4 - Islami & Çobo (1985; në Çobo 1996; Tortonian – Messinian); 5 - Çobo (1986; në Çobo 1996; Tortonian – Messinian); 6 - Vathi & Budri (1986; Miocen

i hershëm); 7 - Vathi (1987; Paleogjen – Akuitanian); 8 - Çobo (1989; Langhian – Tortonian); 9 - Dalipi & Çobo (1989; në Çobo 1996; Tortonian – Messinian); 10 - Vathi (1989; Oligocen i hershëm – i vonshëm); 11 - Vathi & Budri (1990; Oligocen i hershëm – i vonshëm); 12 - Çobo (1992; në Çobo 1996; Burdigalian – Tortonian); 13 - Vathi (1993; Oligocen i vonshëm – Burdigalian); 14 - Vathi et al. (1994; Akuitanian – Langhian); 15 - Kumati et al. (1995; në Pashko 2018; Oligocen i hershëm – Miocen i mesëm); 16 - Vathi (1995; në Xhomo et al. 2002; Oligocen i vonshëm); 17 - Gardin et al. (1996; Tithonian i vonshëm – Valanginian i vonshëm); 18 - Kumati et al. (1997; Oligocen i hershëm – Miocen i mesëm); 19 - Vathi & Kumati (1997; Eocen i mesëm – Burdigalian); 20 - Vathi (1998a; Rupelian i vonshëm – Burdigalian); 21 - Vathi (1998b; Oligocen i hershëm – Miocen i hershëm); 22 - Xhomo et al. (2002; Paleocen – Eocen i mesëm); 23 - Danelian et al. (2007; Barremian i vonshëm – Cenomanian i hershëm); 24 - Kallanxhi et al. (2016; Hatian); 25 - Kallanxhi & Young (2020; Rupelian i vonshëm – Hatian i hershëm); 26 - Kallanxhi (2023; Miocen i hershëm) dhe Kallanxhi et al. (në korrigjim e sipër; Langhian).

Zona Jonike përfshin depozitimet të moshave duke filluar nga Permiani deri në Pliocen dhe është zhvilluar gjatë disa fazave (Xhomo et al. 2002; Aliaj 2012): platformë karbonatike neritike gjatë Permian – Triasikut, sedimentim pelagjik duke filluar nga Doggeri deri në Eocen dhe sedimentim i flihit nga Mioceni i hershëm deri në Mioceni i mesëm.

Ultësira Adriatike shtrihet pjesërisht në pjesët veriore dhe perëndimore të strukturave të palosura të zonave Jonike dhe Krujë dhe përbëhet nga depozitimet molasike me moshë nga Mioceni i mesëm (Serravallian) deri në Pliocen. Ato janë depozituar gjatë dy cikleve sedimentare, i pari është cikli i Mioceni të mesëm – të vonshëm, dhe i dyti, cikli i Plioceni. Cikli i Mioceni të mesëm – i vonshëm mbivendoset në mënyrë transgresive mbi sedimentet e zonës Jonike.

Sedimentimi brenda ultësirës Shqiptare – Thesalliane përfshin disa cikle molasike dhe ka filluar gjatë Eocenit të mesëm duke vazhduar deri në Miocenin e mesëm.

METODOLOGJIA

Nanofosilet gëlqerore mund të studiohen nga shlifet mikropaleontologjike duke përdorur mikroskopin me dritë të polarizuar (Bown & Young 1998), me një objektiv me vaj (100x) (dhe një zmadhim të fushës prej të paktën 1000x), në fushë të errët e polarizuar (XPL), në fushë e ndriçuar (BF), në lente gipsi (GP) dhe faze

kontrasti (PC).

Ndër teknikat më të zakonshme të përgatitjes të preparateve mund të përmenden: shlifi i thjeshtë, me pipetë, sedimentimi me gravitet, centrifugimi dhe mikroskopi elektronik skanues (SEM). Disa teknika mund të përdoren për analizën sasore të të dhënave (studime paleo-ekologjike dhe paleo-oqeanografike), montimi i preparateve për kërkime taksonomike dhe shlifi i hollë në shkëmbinjtë sedimentarë më të fortë.

Për mbledhjen e të dhënave (Bown & Young 1998), mund të përdoren metodat e mëposhtme: numërimi gjysmë sasior, numërimi i thjeshtë i sasisë relative, numërimi i zgjeruar, numërimi për njësi/sipërfaqe, llogaritja e sasisë absolute, numërimi i kurthit të sedimentit dhe analiza e ruajtjes. Numërimi dhe përqindjet e specieve mund të trajtohen në programe të ndryshme statistikore.

Për sa i përket taksonomisë dhe biostratigrafisë standarde të nanofosileve gëlqerore, duhet përmendur se ka disa skema rajonale dhe globale të cilat ndahen sipas intervalit kohor të studiuar dhe rajonit ku bëhet studimi etj.

Në Shqipëri, për faktin se pjesa më e madhe e studimeve janë bërë mbi depozitimet Kenozoike, skemat kryesore standarde biostratigrafike të përdorura për krahasim nga studiuesit shqiptarë kanë qenë ato të: Martini (1971; profile tokësore nga

zonat me gjerësi të ulët), Okada & Bukry (1980; shpime oqeanike) dhe Theodoridis (1984; nga zona e Mesdheut). Në këto skema, zonat përcaktohen nga shfaqja (FO – first occurrence – shfaqja) dhe zhdukja (LO – last occurrence – zhdukja) e specieve treguese, të mbështetura edhe nga disa ngjarje të tjera dytësore.

Në 50 vitet e fundit, biostratigrafia Kenozoike është përmirësuar me studime dhe të dhëna të reja, si: Young (1998; intervali i Miocenit të hershëm deri në të mesëm në gjerësi të mesme dhe të larta), Backman et al. (2012; Miocen), Agnini et al. (2014; për Oligocenin në zonat me gjerësi të ulët deri në mesatare), Kaenel et al. (2017; shpime oqeanike) etj. Disa nga studimet që sollën kontribute të rëndësishme në skemat standarde Mesdhetare janë: Fornaciari & Rio (1996), Fornaciari et al. (1996), Di Stefano et al. (2008), Di Stefano et al. (2011), Iaccarino et al. (2011), Turco et al. (2011) etj.

Për gjerësinë gjeografike të ulët dhe të mesme, Backman et al. (2012) dhe Agnini et al. (2014) përdorin kodet CNO (Nanofosile Gëlqerore Oligocene – Calcareous Nannofossil Oligocene) dhe CNM (Nanofosile Gëlqerore – Calcareous Nannofossil Miocene) për secilën seri, dhe një numër për çdo biozonë. Karakterizimi i biozoneve të tyre bazohet në konceptet e mëposhtme: fillimi (B), Fillim i përbashkët (Bc), Tavani (T), Tavani i përbashkët (Tc) dhe mbivendosja (X) e një specie të caktuar.

Zonimi i Mesdheut ka një qasje të ndryshme dhe është zhvilluar në bazë të analizave sasiore dhe ndryshimeve në abundancën e specieve udhëheqëse, së bashku me shfaqjet dhe zhdukjet e tyre. Terminologjia e përdorur për kodimin e zonave në zonat Mesdhetare është si më poshtë: MNP (Nanoplankton Paleogjen Mesdhe – Mediterranean Nannoplankton Paleogene), MNN (Nanoplankton Neogjen Mesdhe – Mediterranean Nannoplankton Neo-

gene), TRZ (Zonë me Interval të plotë – Total Range Zone), PRZ (Zonë me Interval jo të plotë – Partial Range Zone), IZ (Zonë Intervali), FCO (Shfaqja e përbashkët dhe e vazhdueshme – First Common and Continuous Occurrence), LCO (Zhdukja e përbashkët dhe e vazhdueshme – Last Common and Continuous Occurrence), AB (fillimi i abundancës – Acme Begging), PB (para fillimit i abundancës – Para – Acme Begging) dhe PE (para mbarimit i abundancës – Para-Acme Ending).

Informacion në lidhje me këtë grup mikrofosil mund të gjendet edhe në faqen e internetit Nannotax3 (<http://www.mikrotax.org/Nannotax3>).

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Studimet e para biostratigrafike të bazuara në nanofosile gëlqerore nga Shqipëria dhe zbatueshmëria e tyre në biostratigrafi datojnë që në vitin 1982. Shumica e këtyre studimeve janë ndërmarrë në kuadër të kërkimit të naftës dhe gazit të kryer nga Instituti i Naftës dhe Gazit (Fier, Shqipëri), dhe njihen kryesisht nga Ultësira Adriatike (UA), Zona Jonike (IoZ), Zona e Krujës (KrZ), Zona e Sazanit (SZ) dhe më pak nga Ultësira Shqiptaro – Thessalienne (ATHB).

Zbatueshmëria e nanofosileve gëlqerore në industrinë e naftës dhe gazit përmendet për herë të parë nga Kiçi (1974), i cili dha vetëm një informacion të përgjithshëm mbi këtë tematikë, pa të dhëna specifike kërkimore. Studiuesit e parë që studiuan këtë grup mikrofosil kanë qenë Islami (1982) dhe Islami & Prençi (1983). Ata kanë studiuar depozitimet e Miocenit nga UA dhe kanë caktuar moshën e këtyre sedimenteve si Langhian – Tortoniane. Zonat e identifikuara prej tyre kanë qenë: zona *Sphenolithus heteromorphus*, zona *Discoaster exilis*, zona *Discoaster kugleri*, zona *Discoaster calcaris* dhe zona *Discoaster quinqueramus* (Helvetian – Tortonian i hershëm).

Nga e njëjta zonë, Islami & Çobo (1984) kanë përmendur gjetjet e para në lidhje me linjat evolutive të specieve të Miocenit që i përkasin grupit *Discoaster exilis*. Ata kanë përshkruar disa biozona për intervalin Langhian i hershëm – Tortonian, nga prerjet e UA, duke përmendur praninë e gjinisë *Ceratolithus*, më saktë të species marker *Ceratolithus tricorniculatus*, që tregon moshën Tortoniane e vonshme. Zonimet e përshkruar prej tyre përfshijnë: zonën *Sphenolithus heteromorphus*, zonën *Discoaster exilis*, zonën *Discoaster kugleri*, zonën *Discoaster calcaris*, zonën *Discoaster quinqueramus* dhe nënzonën *Ceratolithus tricorniculatus*.

Islami & Çobo (1985) kanë dhënë informacion shtesë mbi shtrirjen kohore të nënzonës *Ceratolithus tricorniculatus*, duke vendosur për herë të parë në Shqipëri, kufirin Messinian/Pliocen bazuar në nanofosile gëlqerore. Ata ristudiuin disa kampione të prerjes Rrogozhina, që përmbanin bashkëshoqërime të pranuar më parë si pjesë e zonave *Sphenolithus heteromorphus*, *Discoaster exilis* dhe *Discoaster kugleri* (Langhian deri në Serravallian), dhe ripërcaktuan pjesën e poshtme të këtij profili si moshë Tortoniane e mesme e zonës *Discoaster calcaris*. Nga depozitimet Tortonian – Messiniane të UA në shpimet Frakull – Seman – Ardenicë – Divjakë, Çobo (1986) përshkroi bashkëshoqërime që i përkasin zonës *Discoaster quinqueramus*.

Sedimentet flishore të Zonës Jonike u studiuan nga Vathi (1985) i cili përcaktoi disa biozona me nanofosile gëlqerore. Vathi & Budri (1986) kanë studiuar depozitimet e Miocenit të poshtëm nga zona e Kurveleshit dhe kanë përmendur zonat *Helicosphaera carteri* dhe *Helicosphaera scissura*. Kufiri Paleogjen/Neogjen në Zonën Jonike u vendos në shfaqjen e species *Helicosphaera carteri* në prerjet Aranitas dhe Lapardha (Vathi 1987).

Në depozitimet e Miocenit të UA, disa biozona dhe ngjarje të nanofosileve gëlqerore janë përmendur nga Çobo (1989; Langhian në Tortonian), si më poshtë: zona *Sphenolithus heteromorphus* (në prerjet Ndroq, Ngjegar, Lushnjë), zona *Discoaster exilis* (prerjet Ndroq, Ngjegar, Lushnjë, Zvërnec), zona e *Discoaster kugleri* (prerjet Ndroq, Lushnjë, Zvërnec), zona *Discoaster calcaris* (Ndroq, Rrogozhinë, Bishti i Pallës, Kavajë, Patos + pusët në Zvërnec), zona *Discoaster quinqueramus* (prerjet dhe pusët Rrogozhina, Bishti i Pallës, Kavaja, Patos) dhe zona *Ceratolithus tricorniculatus* (prerja Kavajë).

Hulumtimet e kryera nga Dalipi & Çobo (1989) mbi depozitimet Tortonian – Messiniane nga UA, kanë dhënë informacione të reja mbi praninë dhe diapazonin e specieve *Discoaster surculus*, *Discoaster neorectus* dhe *Discoaster subsurculus*.

Një studim më i gjerë mbi depozitimet e fllshit Oligocenik të Zonës Jonike (prerjet Aranitasi, Saranda, Berati dhe Tomorri) u botua nga Vathi (1989), i cili zbuloi bashkëshoqërime të nanofosileve gëlqerore që i përkasin zonës *Helicosphaera reticulata* dhe dy nënzonave të saj: nënzona *Ericsonia subdisticha* s.l. (LO e *Discoaster barbadiensis* & *D. saipanensis* deri në mbarimin e acme të *Ericsonia subdisticha* s.l.; sensu lato – kuptim të gjerë) dhe nënzona *Helicosphaera recta* (mbarimi i acme të *Ericsonia subdisticha* s.l. deri në FO e *Cyclicargolithus abisectus*). Nga prerjet Aranitasi dhe Saranda përmenden zonat *Sphenolithus predistentus* (FO e *Cyclicargolithus abisectus* – FO e *Sphenolithus ciperoensis*; kufiri i poshtëm i ndryshuar; Vathi 1985) të moshës Rupeliane dhe *Sphenolithus distentus* (FO e *Sphenolithus ciperoensis* – LO e *Sphenolithus distentus*) me moshë Rupelian – Oligocen i hershëm. Zona *Sphenolithus ciperoensis* (LO e *Sphenolithus distentus* – LO e *Sphenolithus ciperoensis*; kufiri i sipërm i ndryshuar) është përmendur nga prerjet e Aranitasit dhe

Sarandës, ndërsa zona *Sphenolithus delphix* (LO e *Sphenolithus ciperoensis* – FO e *Helicosphaera carteri*; e modifikuar këtë vepër) nga prerjet e Aranitasit, Sarandës, Beratit dhe Tomorrit. Këto dy zonat e fundit i përkasin katit Hatian.

Ky studim ka përshkruar një specie të re, *Reticulofenestra sarandae* (me shtrije nga zona *Helicosphaera reticulata* deri në zonën *Sphenolithus distentus*) dhe ka riemërtuar tre specie të tjera si: *Pontosphaera ovata* (nga zona *Sphenolithus ciperoensis* në prerjen e Sarandës; zonat *Helicosphaera reticulata* dhe *Sphenolithus predistentus* në prerjen e Aranitasit), *Pontosphaera segmenta* (nga zona *Sphenolithus ciperoensis* në prerjen e Sarandës) dhe *Cyclicargolithus marismontium* (në të gjitha prerjet). Ky studim tregon gjithashtu se disa nga speciet marker (*Cyclococcolithus formosus*, *Reticulofenestra umbilicus*, *Triquetrorhabdulus carinatus* dhe *Discoaster druggii*) nuk janë të përshtatshme për zonimin e këtij rajoni.

Depozitimet e Oligocenit të hershëm – të vonshëm të prerjes Osmanzeza-1 (Zona Jonike, Nënzona e Beratit) u përcaktuan nga Vathi & Budri (1990) se u përkasin zonave *Sphenolithus predistentus*, *Sphenolithus distentus* dhe pjesën e poshtme të zonës *Sphenolithus ciperoensis*. U përmend gjithashtu prania e specieve *Helicosphaera carteri* në zonat NP23 – NP24 (Vathi 1998b).

Çobo (1992) ka studiuar intervalin Miocen i poshtëm – Tortonian në disa prerje nga UA dhe Zona Jonike, duke evidentuar pranimë e disa zonave dhe nënzonave nanofosile, si: zona *Helicosphaera carteri*, nënzona *Discoaster deflandrei* (LO/zhdrukja e *Sphenolithus dissimilis* – FO e *Helicosphaera ampliaptera*), nënzona *Dictyococcites hesslandii* (FO/shfaqja e *Helicosphaera ampliaptera* – FO e *Sphenolithus heteromorphus*), zona *Helicosphaera ampliaptera* (FO e *Sphenolithus heteromorphus* – FO e

Discoaster exilis), zona *Sphenolithus heteromorphus* (FO e *Discoaster exilis* – LO e *Sphenolithus heteromorphus*), zona *Discoaster variabilis* (LO e *Sphenolithus heteromorphus* – FO e *Discoaster pentaradiatus*), zona *Discoaster quinqueramus* (FO – LO e *Discoaster quinqueramus*) dhe zona *Ceratolithus tricorniculatus* (LO e *Discoaster pentaradiatus* – kufiri i sipërm nuk është kapur).

Prerjet me moshë Oligocen i vonshëm – Burdigalian nga Njësia Kurveleshi dhe nga nënzona Jonike e Jashtme u studiuan nga Vathi (1993) dhe si përfundim u caktuan këto zona: *Sphenolithus ciperoensis* (LO e *Sphenolithus distentus* – LO e *Sphenolithus ciperoensis*; e ndryshuar nga Vathi 1985; Vathi & Budri 1986; prerjet Aranitas, Andon Peçi, Ballaj, Bolena, Memoraq dhe Lapardha) dhe zona *Sphenolithus delphix* (LO e *Sphenolithus ciperoensis* – FO e *Helicosphaera carteri*; e ndryshuar nga Vathi 1989; në prerjet Aranitas, Andon Peçi, Ballaj, Bolena, Memoraq dhe Lapardha) të moshës Hatiane. Sipas këtij studimi, speciet *Dictyococcites bisectus*, *Ericsonia fenestrata*, *Helicosphaera recta* dhe *Zygrhablithus bijugatus* nuk janë markera të përshtatshëm për kufirin Paleogjen/Neogjen. Nga Mioceni i hershëm u përmendën zonat *Helicosphaera carteri* (FO e *Helicosphaera ampliaptera* – FO e *Helicosphaera ampliaptera*; e ndryshuar nga Vathi & Budri 1986; në prerjet Aranitas, Andon Peçi, Ballaj, Bolena, Memoraq dhe Lapardha) dhe vetëm nga një prerje, zona *Helicosphaera scissura* (FO of *Helicosphaera ampliaptera* – FO of *Sphenolithus heteromorphus*; e ndryshuar nga Vathi & Budri 1986; prerjet Ballaj, Nënzona Jonike e Mesme, njësia Kurveleshi).

Vathi et al. (1994) hetoi nanofosilet gëlqerore të Mioceni të hershëm – të mesëm nga prerja e Drenovës, e vendosur në jug të qytetit të Fierit dhe caktoi këto depozitime intervalit Akuitanian – Langhian.

Në zonën e Sazanit (Kepi e Gjuhëzës),

zona e Oligocenit të vonshëm NP25 – *Sphenolithus ciperoensis* është përmendur nga Vathi (1995, në Xhomo et al. 2002). Kumati et al. (1995; në Pashko 2018) ka përcaktuar disa zona të ultësirës Shqiptaro – Thessaliane në intervalin Rupelian të sipërm (NP24) – Langhian (NN5).

Sedimentet që i përkasin flijshit të Firzës u datuan për herë të parë bazuar në nanofosilet gëlqerore si Tithonian i sipërm – Valanginian i sipërm nga Gardin et al. (1996).

Sedimentet e Ultësirës Shqiptaro – Thessaliane janë studiuar nga Kumati et al. (1997) me anë të nanofosileve gëlqerore, polenit dhe foraminiferave dhe një pjesë e këtyre formacioneve janë përfshirë në intervalin Rupelian (zona NP24) – Langhian (zona NN5). Në Ultësirën Shqiptaro – Thessaliane, zona *Sphenolithus distentus* u përmend nga Formacioni i Drenovës, ndërsa zonat *Helicosphaera carteri*, *Helicosphaera scissura* dhe *Helicosphaera ampliaptera* nga prerjet Sinica, Palas dhe Nikolica. Nga prerja e Sinicës është identifikuar gjithashtu zona *Sphenolithus heteromorphus* me moshë Langhiane.

Depozitimet e Eocenit të mesëm dhe të Burdigalianit nga bregu perëndimor i liqenit të Ohrit (verilindje të Ultësirës Shqiptaro – Thessaliane) u studiuan nga Vathi & Kumati (1997).

Nga depozitimet Oligocen – Mioce-nike të Zonës Jonike, Vathi (1998a) ka përmendur zonat *Sphenolithus distentus*, *Sphenolithus ciperoensis*, *Helicosphaera carteri* dhe *Helicosphaera scissura* (Papër – Rovë, Përroi i Gurave/Terbacit), Përroi i Melinth). Në të njëjtin vit, Vathi (1998b) botoi një punim mbi shfaqjen e *Helicosphaera carteri* në biozonat NP23 – NP24 (Rupelian – Hatian i poshtëm) nga disa prerje dhe puse në Zonën Jonike (Papër-4, Bistrovic-2, Rova-1). Disa zona nanofosile janë përmendur nga këto vende: Kodovjat, Lubinja dhe Tenda e Qypit (NP24 – zona *Sphenolithus distentus*), Luzaj, Berati dhe Uji i Zi (in-

tervali nga zona NP21 deri në zonën NP25), Tomorr dhe Kelqyra (zonat NP21 deri NP24), Osmanzeza-1 (NP23 – NP25), Gjorm (NP21 – NN2), dhe Krujë (NP21 – NP23).

Sedimentet e Njesisë Lisën – Spiten u datuan në bazë të nanofosileve gëlqerore si të Paleogjenit, më saktë të Eocenit të hershëm (Xhomo et al. 2002).

Danelian et al. (2007) ka përcaktuar moshën e depozitimeve të prerjes së Sopotit në Zonën Jonike si Barremian i vonshëm – Cenomanian i hershëm (zonat NC6 deri në NC10).

Studimet më të fundit mbi nanofosilet gëlqerore nga Shqipëria janë bërë në depozitimet molasike të Ultësirës Shqiptaro – Thessaliane (Fig. 2), në rrethinat e qytetit Korçë (fshatrat Mborje, Drenovë, Miras, Dardhë) dhe kapin një interval nga Rupelian i mesëm deri në Miocenin e mesëm (Kallanxhi et al. 2016; Kallanxhi 2020; Kallanxhi & Young 2020; Kallanxhi 2023). Qëllimi i këtyre studimeve kanë qenë rivlerësimi nga ana biostratigrafike të këtyre depozitimeve, analizimi i bashkëshoqërimeve të nanofosileve gëlqerore dhe paleoekologjisë së tyre, duke përdorur jo vetëm vëzhgime të drejtpërdrejta dhe qasje cilësore, por edhe metoda bashkëkohore sasiore dhe pastaj statistikore (Kallanxhi 2020).

Duke u bazuar në shfaqjet e specieve marker kryesore dhe dytësore, gjithashtu edhe në bollëkun e dokumentuar për speciet e tjera përgjatë prerjeve, janë dokumentuar disa biozona karakteristike (sipas Martini 1971 dhe Okada & Bukry 1981) për intervalin Oligocen – Miocen i mesëm, si më poshtë: zonat *Sphenolithus predistentus* (NP23)/*Sphenolithus predistentus* (CP17), zona *Sphenolithus distentus* (NP24)/nënzona *Cyclicargolithus floridanus* (CP19a), zona *Sphenolithus ciperoensis* (NP25)/*Reticulofenestra bisecta* (CP19b), zona *Discoaster druggii* (NN2)/nënzona *Discoaster druggii*

(CN1c), zona *Sphenolithus belemnus* (NN3)/zona *Sphenolithus belemnus* (CN2), zona *Helicosphaera ampli-erta* (NN4)/zona *Helicosphaera ampli-erta* (CN3) dhe zona *Sphenolithus heteromorphus* (NN5)/zona *Sphenolithus heteromorphus* (CN4).

Për një përcaktim më të mirë të moshës, disa nga zonat e sipërpërmendura u krahasuan gjithashtu me zonimet mesdhetare dhe të tilla depozitimet e studiuar janë përfshirë në këto biozona: *Sphenolithus ciperensis* PRZ (MNP25a; Chattian), *Helicosphaera ampli-erta* PRZ (MNN2b; Burdigalian i hershëm), *Sphenolithus belemnus* TRZ (MNN3a; Burdigalian i mesëm), *Coronocyclus nitescens* IS (nënzona MNN4c; MNN4 – *Helicosphaera ampli-erta* IZ; Langhian i hershëm) dhe *Sphenolithus heteromorphus*/*Helicosphaera waltrans* IS (nënzona MNN5a; MNN5 – *Sphenolithus heteromorphus* IZ; Langhian). Këto studime dokumentojnë disa ngjashmëri por edhe ndryshime midis bashkëshoqërimeve të nanofosileve gëlqerore të përshkruara dhe disa prej studimeve të publikuara më parë në Shqipëri dhe sjellin informacion sasiore mbi grupet dhe speciet taksonomike më të bollshme.

Specia me e bollshme e dokumentuar përgjatë intervalit të studiuar është *Reticulofenestra minuta*, e ndjekur nga grupi *Reticulofenestra* me përmasa të vogla (3 – 5 µm) me zonë qendrore të mbyllur (*R. antarctica* + *R. producta*). Për shkak se specia *Reticulofenestra producta* (FO është në Miocenin i hershëm) u identifikua në të gjitha biozonat, diapazoni i këtij taksoni u zgjerua deri në pjesën e sipërme të zonave NP23/CP17 të moshës Rupelian i mesëm.

Ndër taksonet që i përkasin gjinisë *Helicosphaera* është *Helicosphaera minima* (Kallanxhi & Young 2020), një specie jashtëzakonisht e rrallë, e cila u gjet në depozitimet Oligocenike të zonës së Moravës (Ultësirës Shqiptaro – Thessaliane, Shqipëri), duke e bërë këtë shfaqjen e dytë në botë.

Kallanxhi & Young (2020) kanë kryer analiza morfometrike në ekzemplarë të përzgjedhur dhe si përfundim kanë përcaktuar madhësinë dhe karakteristikat morfologjike të kësaj specie. Gjithashtu, sipas këtij studimi, diapazoni i njohur kohor u zgjerua nga NP22 (Rupelian i hershëm) në NP24 (Rupelian i vonshëm – Hatian i hershëm).

Për sa i përket gjinisë *Sphenolithus*, vlen të përmendet se me përfshirjen e specieve marker *Sphenolithus capricornutus* e cila nuk është regjistruar në këto studimet të fundit, pjesa tjetër e specieve treguese (mesi i Rupelianit deri në Langhian), janë dokumentuar përgjatë intervalit të hulumtuar (Kallanxhi 2020). Për herë të parë, specia me jetëgjatësi të shkurtër *Sphenolithus pseudoheteromorphus* u përmend nga molasat e Burdigalianit të hershëm të Ultësirës Shqiptaro – Thessaliane në territorin shqiptar (Kallanxhi 2023). Prania në sasi të ulët e gjinisë *Discoaster*, e njohur se lulëzon në mjedisë të ngrohta pelagjike, është një tregues i mirë i kushteve paleomjedisore, duke treguar në përgjithësi një pellg neritik të cekët.

Hulumtimet sasiore të specieve *Sphenolithus heteromorphus* nga biozonat NN5/CN4 të moshës Langhiane (Kallanxhi 2020), dhe krahasimi me prerjet e tjera mesdhetare, lejuan përmirësimin e kuadrit biostratigrafik dhe caktimin e moshës së disa prej profileve të studiuar në dy prej zonave e skemës Mesdhetare (*Coronocyclus nitescens* IS – MNN4c dhe *Sphenolithus heteromorphus*/*Helicosphaera waltrans* IS – MNN5a). Kjo mbështetet edhe nga të dhënat e foraminiferëve mbi këtë material (Kallanxhi 2020).

Studimet më të fundit mbi sedimentet molasike të Ultësirës Shqiptaro – Thessaliane ofrojnë një pasqyrë të detajuar mbi shpërndarjen hapësinore dhe kohore të bashkëshoqërimeve të nanofosile gëlqerore, duke vënë në dukje ngjashmëritë dhe ndryshi-

met nga krahasimi i tyre me skema të ndryshme standarde globale dhe rajonale. Nga pikëpamja biostratigrafike, këto studime (Kallanxhi 2020; Kallanxhi 2023) mbështesin përcaktimin e moshës për pjesë të formacioneve të ndryshme dhe paraqesin një pozicion stratigrafik më të qartë në katet e Shkallës Ndërkombëtare Kronostratigrafike. Ato gjithashtu ndihmojnë në një shpjegim më të mirë të paleoekologjisë së specieve

të ndryshme të nanofosileve gëlqerore dhe bashkëshoqërimeve të tyre dhe japin të dhëna të reja mbi kushtet e sedimentimit dhe paleomjedisore (kripësia e sipërfaqes së detit, temperatura, furnizimi me lëndë ushqyese terrigjene, rritja e lëndëve ushqyese nga fundi i detit, përzjerja e shtresave së kolonës së ujit) në këtë pellg gjysëm të mbyllur dhe në mjediset e tij anësore.




Figura 2. Nanofosile gëlqerore nga Ultësira Shqiptaro – Thessaliane (1 – 25 nanofosile me moshë Oligocenike; 26 – 31 nanofosile me moshë Miocenike; të gjitha fotografitë në mikroskop janë bërë nga autori i këtij artikullit; XPL – fushë e errët; GP – lente gipsi; *1 njëjti nanofosil).

PËRFUNDIME

Ky artikull bazohet pjesërisht në literaturën ekzistuese të autorëve të ndryshëm shqiptarë që kanë studiuar këtë grup mikrofossil, që nga hyrja e tij si një metodë e re në kërkimin e hidrokarbureve dhe gazit në Shqipëri dhe në studime biostratigrafike. Këto studime shtrihen në një interval afërsisht 16 vite, midis viteve 1982 dhe 1998, interval i cili përfaqëson kulmin e hetimeve mikropaleontologjike në vend. Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e këtyre studimeve janë bërë në prerje tokësore dhe në puse nga depozitime flishore dhe molasike Paleogene dhe Neogene, të kryera brenda kuadrit të kërkimit të naftës. Studimet e fundit mbi molasën e Ultësirës Shqiptaro – Thessalienne

janë kryer me qëllim përmirësimit e kuadrit biostratigrafik në zonë, krahasimin e materialit me skema standarde të njohura, për të nxjerrë në pah dobinë e këtij grupi në studimet biostratigrafike, për të përcaktuar sasinë e nanofosileve gëlqerore dhe jo më pak e rëndësishme, për të vlerësuar paleoekologjinë e tyre dhe për të vënë në dukje rëndësinë e tyre në hetimet paleomjedisore. Megjithatë, ky artikull përmbledh pothuajse të gjitha studimet e njohura për nanofosilet gëlqerore në Shqipëri, nuk përjashtohet që për shkak të vështirësive në gjetjen e literaturës për këtë tematikë, disa vepra mund të mos jenë gjetur dhe përfshirë në këtë përmbledhje.

REFERENCAT

- AGNINI C., FORNACIARI E., RAFFI I., CATANZARITI R., PÄLIKE H., BACKMAN J. & RIO D. (2014). Biozonation and biochronology of Paleogene calcareous nannofossils from low and middle latitudes. *Newsletters on Stratigraphy*, 47(2), 131-181. <http://dx.doi.org/10.1127/0078-0421/2014/0042>
- ALIAJ SH. (2012). Neotektonika e Shqipërisë. Tiranë, p. 292.
- BACKMAN J., RAFFI I., RIO D., FORNACIARI E. & PÄLIKE H. (2012). Biozonation and biochronology of Miocene through Pleistocene calcareous nannofossils from low and middle latitudes. *Newsletters on Stratigraphy*, 45, 221-244. Doi: 10.1127/00780421/2012/0022.
- BOWN P.R. & YOUNG J.R. (1998). Calcareous Nannofossil Biostratigraphy (British Micropalaeontological Society Publications Series; Bown P.R., Ed.), Chapman and Kluwer Academic, London, p. 288
- BRAARUD T., DEFLANDRE G., HALDAL P. & KAMPTNER E. (1955A). Terminology, nomenclature, and systematics of the Coccolithophoridae. *Micropaleontology*, 1(2), 157-159.
- BRAARUD T., DEFLANDRE G., HALDAL P. & KAMPTNER E. (1955B). Terminologie, nomenclature et systematique chez les Coccolithophorides. *Compte Rendu 8th International Botanical Congress*, (Paris, 1954), 17, 69-70.
- ÇOBO L. (1986). Biostratigrafia e depozitimeve të Tortonianit – Mesinianit në rajonet Divjakë, Ardenicë, Frakull dhe Sema, në bazë të nanofosileve gëlqerore (Biostratigraphy of the Tortonian - Messinian deposits in Divjakë, Ardenicë, Frakull and Sema regions, based on calcareous nannofossils). *Fondi i Institutit Gjeologjik të Naftës, Fier*.
- ÇOBO L. (1989). Biozonimi i depozitimeve miocenike në disa prerje të Ultësirës Pranadriatike në bazë të studimit të nanoplanktonit gëlqeror (Biozonation of the Miocene deposits in some sections of Pre-Adriatic depression based on calcareous nannoplankton). *Bulletini Nafta dhe Gazi, Fondi i Institutit Gjeologjik të Naftës, Fier*, 2, 93-106.
- ÇOBO L. (1992). Biostratigrafia e depozitimeve të kateve Burdigalian – Langhian – Serravallian – Tortonian, në bazë të nanofosileve gëlqerore, në Zonën Ionike dhe UPA të Shqipërisë (Biostratigraphy of the Burdigalian - Langhian - Serravallian – Tortonian deposits of the Ionian Zone and UPA, in Albania, based on calcareous nannofossils). *Fondi i Institutit Gjeologjik të Naftës, Fier*.
- ÇOBO L. (1996). Evolucion i rezultateve të arritura nga studimi i nanofosileve gëlqerore në depozitetet Miocenike të vendit tonë (Evolution of the results achieved on calcareous nannofossils study from the Miocene deposits in our country). *Nafta Shqiptare*, 2, 81-85.
- DALIPI V. & ÇOBO L. (1989). Biostratigrafia dhe paleogeografia e depozitimeve të Tortonian - Mesinianit me metodën e mikrofaunës dhe nanoplanktonit në UPA (Biostratigraphy and paleogeography of Tortonian - Messinian deposits, based on microfauna and calcareous nannoplankton from UPA). *Fondi i Institutit Gjeologjik të Naftës, Fier*.
- DALIPI V., LACKA V., PRILLO S. & PLAHU DRITA (1985). Biostratigrafia e depozitimeve të Tortonianit në pjesën perëndimore të Ultësirës Pranadriatike (Biostratigraphy of Tortonian deposits from the western part of Pre-Adriatic Depression). *Nafta dhe Gazi*, 4, 3-12.
- DANELIAN T., BAUDIN F., GARDIN S., MASURE E., RICORDEL C., FILI I., MEÇAJ T. & MUSKA K. (2007). The record of mid Cretaceous oceanic anoxic events from the Ionian zone of southern Albania. *Revue de Micropaléontologie*, 50(3), 225-237. <https://doi.org/10.1016/j.revmic.2007.06.004>
- DI STEFANO A., FORESI L. M., LIRER F., IACCARINO S. M., TURCO E., AMORE F. O., MAZZEI R., MORABITO S., SALVATORINI G. & ABDUL AZIZ H. (2008). Calcareous plankton high resolution bio-magnetostratigraphy for the Langhian of the Mediterranean area. *Rivista Italiana di Paleontologia e Stratigrafia*, 114(1), 51-76.
- DI STEFANO A., VERDUCCI M., MANISCALCO R., SPERANZA F. & FORESI L.M. (2011). High-resolution stratigraphy of the Contrada Pesciareello borehole succession (SE Sicily): a lower Langhian reference section for the Mediterranean region. *Stratigraphy*, 8, 111-124.
- FORNACIARI E. & RIO D. (1996). Latest Oligocene to early middle Miocene quantitative calcareous nannofossil biostratigraphy in the Mediterranean region. *Micropaleontology*, 42(1), 1-36. <http://dx.doi.org/10.2307/1485981>
- FORNACIARI E., DI STEFANO A., RIO D. & NEGRI A. (1996). Middle Miocene calcareous nannofossil biostratigraphy in the Mediterranean region. *Micropaleontology*, 42(1), 37-63.
- GARDIN S., KIÇI V., MARRONI M., MUSTAFA F., PANDOLFI L., PIRDENI A. & XHOMO A. (1996). Litho- and biostratigraphy of the Firza flysch, ophiolite Mirdita nappes, Albania. *Ofoliti*, 21(1), 47-54.
- IACCARINO S., DI STEFANO A., M. FORESI L.M., TURCO E., BALDASSINI N., CASCELLA A., DA PRATO S. FERRARO, L. GENNARI R., HILGEN F.J., LIRER F., MANISCALCO R., MAZZEI R., RIFORGIATO F., RUSSO B., SAGNOTTI L., SALVATORINI G., SPERANZA F. & VERDUCCI M. (2011). High-resolution integrated stratigraphy of the upper Burdigalian-lower Langhian in the Mediterranean: the Langhian historical stratotype and new candidate sections for defining its GSSP. *Stratigraphy*, 8: 199-215.
- ISLAMI XH. (1982). Nëndarja e depozitimeve të Tortonianit në disa prerje e puse të pjesës perëndimore të Ultësirës Pranadriatike me anë studimit të nanoplanktonit (Calcareous nannoplankton zonation of Tortonian deposits from several outcrops and boreholes from the western part of Pre-Adriatic Depression). *Fondi i Institutit Gjeologjik të Naftës, Fier*.
- ISLAMI XH. & PRENÇI J. (1983). Mbi mundësinë e ndarjes së depozitimeve të Miocenit të mesëm nëpër rmjet studimit të nanoplanktonit gëlqeror në disa prerje e puse të Ultësirës Pranadriatike (Zonation of the Middle Miocene deposits by the mean of calcareous nannofossils in some outcrops and drills in UPA). *Fondi i Institutit Gjeologjik të Naftës, Fier*.
- ISLAMI XH. & ÇOBO L. (1984). Studimi i nanoplanktonit gëlqeror në depozitetet e Tortonianit në pjesën lindore të Ultësirës Pranadriatike dhe bashkëlidhja me pjesën perëndimore (Calcareous nannoplankton investigation in Tortonian deposits from the eastern part of the Pre-Adriatic Depression and its connection to the western side). *Fondi i Institutit Gjeologjik të Naftës, Fier*.
- ISLAMI XH. & ÇOBO L. (1985). Studimi dhe përgjithësimi i depozitimeve të Tortonian – Mesinianit në disa prerje sipërfaqësore të UPA në bazë të nanofosileve gëlqerore (Ongoing investigation on Tortonian - Messinian deposits from some outcrops from the UPA, based on calcareous nannofossils). *Fondi i Institutit Gjeologjik të Naftës, Fier*.
- DE KAENEL E., BERGEN J. A., BROWNING E., BLAIR S. A. & BOESIGER T. M. (2017). Uppermost Oligocene to Middle Miocene Discoaster and Catinastr taxonomy and stratigraphy in the circum North Atlantic Basin: Gulf of Mexico and ODP Leg 154. *Journal of Nannoplankton Research*, 37(2-3), 215-244.
- KALLANXHI M.-E., ÇORIĆ S. & KOÇIU A. (2016). Late Oligocene calcareous nannofossils from Albanian-Thessalian intramontane basin (Bozdovec Section, Albania) - a quantitative approach, *Studia UBB Geologia*, 60(1), 5-20. Doi: <http://dx.doi.org/10.5038/1937-8602.60.1.1286>
- KALLANXHI M.-E. & YOUNG J.R. (2020). Rediscovery of the Helicosphaera minima in the Oligocene deposits of the Albanian-Thessalian Basin (Albania). *Journal of Nannoplankton Research*, 38(1), 17-26.
- KALLANXHI M.-E. (2020). Calcareous nannofossils from Oligocene to middle Miocene deposits of the Albanian-Thessalian Basin (Albania). *PhD Thesis*, p. 272.
- KALLANXHI M.-E. (2023). Biostratigraphy of calcareous nannofossils and palaeoenvironments in the Lower Miocene of the Albanian-Thessalian Basin (Albania). *Geologica Carpathica*, 74(1), 41-58.
- KIÇI V. (1974). Nanoplanktoni dhe rëndësia e tij për kërkimet e naftës (Nannoplankton and its importance in petroleum research). *Nafta dhe Gazi*, 3, 8-13.
- KUMATI LL., KORROVESH T., MYFTARI S., VATHI K., MARKU D., SADUSHI P., GJANI E., DULAJ A., SHTREPI P., SEITI

E., VEIZAI V., ZAKA M. & POLO S. (1997). Study on the structure, biostratigraphy, depositional environment and geochemical potential of Shqiptaro-Thessalian- Mesohellenik Basin, in Burrel-Korça-Greece region). *Instituti i Studimeve dhe i Projektmeve Gjeologjike te Naftës dhe Gazit, Fier.*

KUMATI LL., MYFTARI S. & VATHI K. (1995). Stratigraphy and paleo-bathymetric interpretation of the Korça graben deposits. *Nafta Shqiptare*, 1, 17-35.

MARTINI E. (1971). Standard Tertiary and Quaternary calcareous nannoplankton zonation. In: Proceedings 2nd International Conference on Planktonic Microfossils Roma 1970 (Farinacci, A., Ed.). *Edizioni Tecnoscienza*, Roma, 2, 739-785.

OKADA H. & BUKRY D. (1980). Supplementary modification and introduction of code numbers to the low-latitude coccolith biostratigraphic zonation (Bukry, 1973; 1975). *Marine Micropaleontology*, 5, 321-325. [http://dx.doi.org/10.1016/0377-8398\(80\)90016-x](http://dx.doi.org/10.1016/0377-8398(80)90016-x)

PASHKO P. (2018). Morave Mt. Oligocene-Middle Miocene succession of Albanian-Thessalian Basin. *Bulletin of the Geological Society of Greece*, 52(1), 1-44. <https://doi.org/10.12681/bgsg.15837>

THEODORIDIS S. (1984). Calcareous nannofossil biostratigraphy of the Miocene and revision of the helicoliths and discoasters. *Utrecht Micropaleontological Bulletin*, 32, 1-271.

TURCO E., CASCELLA A., GENNARI R., HILGEN F.J., IACCARINO S.M. & SAGNOTTI L. (2011). Integrated stratigraphy of the La Vedova section (Conero Riviera, Italy) and implications for the Burdigalian/Langhian boundary. *Stratigraphy*, 8(2-3), 89-110.

VATHI K. (1985). Les nannofossiles calcaires du flysch de la zone ionienne d'Albanie (PhD Thesis). *Mémoire des Sciences de la Terre, Université Curie, Paris*, nr. 85-19, p. 124.

VATHI K. (1987). Kufiri Paleogjen – Neogjen në Shqipërinë jugperëndimore (Zona Jonike) bazuar në të dhënat e nannofosileve gëlqerore (The Paleogene – Neogene boundary in the south-western Albania (Ionian Zone) based on calcareous nannofossils). *Instituti Gjeologjik i Naftës Fier, Buletini Nafta dhe Gazi*, 2, 87-100.

VATHI K. (1989). Zonimi i flishit të Zonës Ionike në bazë të nanofosileve gëlqerore (Calcareous nannofossil zonation of the flysch deposits of the Ionian Zone). *Instituti Gjeologjik i Naftës Fier, Buletini Nafta dhe Gazi*, 1, 57-70.

VATHI K. (1993). Biostratigrafia e depozitave të Oligocenit të sipërm – Miocenit të poshtëm të zonës Ionike (kryesisht brezit të Kurveleshit) në bazë të nanofosileve gëlqerore (Calcareous nannofossil biostratigraphy of late Oligocene – early Miocene deposits in the Ionian Zone - Kurveleshi Subzone). *Instituti Gjeologjik i Naftës Fier, Buletini Nafta dhe Gazi*, 4, 51-71.

VATHI K. (1998a). Biostratigrafia e depozitave flishore Oligo-Miocenike në rajonin Paper – Rovë bazuar në të dhënat e nanofosileve gëlqerore (Biostratigraphy of the Oligocene-Miocene flysch deposits from Paper-Rovë based on calcareous nannofossils). *Instituti Gjeologjik i Naftës Fier, Buletini Nafta Shqiptare*, 53-62.

VATHI K. (1998b). A note on the first occurrence of *Helicosphaera carteri* in the Early Oligocene (NP23, Sphenolithus predistatus Zone). *Journal of Nannoplankton Research*, 20(1), 39-43.

VATHI K. & BUDRI E. (1986). Dëshirimi biostratigrafik i depozitave të Oligocenit të sipërm – Miocenit të poshtëm të zonës Jonike (kryesisht brezit të Kurveleshit) në bazë të nanofosileve gëlqerore (Biostratigraphical interpretation of the Late Oligocene-Early Miocene deposits from Ionian Zone, Kurveleshi Area, based on calcareous nannofossils). *Fondi i Institutit Gjeologjik të Naftës, Fier*.

VATHI K. & BUDRI E. (1990). Biostratigrafia e prerjes gjeologjike të Ozmanezës bazuar në nanofosilet gëlqerore (Calcareous nannofossils based biostratigraphy of the Ozmanzeza section). *Buletini Nafta dhe Gazi*, 4, 31-36.

VATHI K., FILI I. & ODIN G.S (1994). Niveaux volcanoclastiques du Miocène inférieur et moyen d'Albanie. *Giornale di Geologia*, 3, 56(1), 115-123.

VATHI K. & KUMATI L. (1997). Middle Eocene and Burdigalian – the bio-stratigraphic new dating (nannoplankton) on western coast of Ohri lake (Korça depression) (unpublished report).

XHOMO A., KODRA A., XHAFA Z. & SHALLO M. (2002). Gjeologjia e Shqipërisë – Tekst shpjegues i hartës 1:200 000 (Albanian Geology - Explanatory text of map 1: 200 000). *Ministria e Industrisë dhe Energjitikës, Ministria e Arimit dhe Shkencës, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Albpetrol, Universiteti Politeknik i Tiranës, Tirana*, p. 435.

YOUNG J.R. (1998). Neogene. In: Calcareous nannofossil biostratigraphy (Bown, P.R., Ed.). *Kluwer Academic Publications Dordrecht*, 225-265. <http://dx.doi.org/10.1007/978-94-011-4902-08>

YOUNG J.R., DIDYMUS J.M., BOWN P.R., PRINS B. & MANN S. (1991). Crystal assembly and phylogenetic evolution in heterococcoliths. *Nature*, 356, 516-518.

YOUNG J.R., BOWN P.R. & LEES J.A. (2022). Nannotax3 website. International Nannoplankton Association. Accessed 21 Apr. 2022. URL: www.mikrotax.org/Nannotax3.

EVOLUTION OF CALCAREOUS NANNOFOSSIL STUDIES IN ALBANIA

MĂDĂLINA – ELENA KALLANXHI^{1*}

¹Albanian Geological Survey, Zef Serembe St., Tirana, Albania.

*Corresponding author: madalina_kallanxhi@yahoo.com

(Manuscript submitted in August 2023; accepted for publication in November 2023)

ABSTRACT

Calcareous nannofossils are calcareous remains belonging to Haptophyte algae and represent one of the most widespread groups in the recent oceans and in the fossil record. Due to their high abundance, nannofossils are a good tool for biostratigraphy, hydrocarbon exploration and scientific research. This paper presents the evolution of the calcareous nannofossil studies in Albania, starting from their introduction as a new micropaleontological method by the Institute of Oil and Gas Fier in 1982. The calcareous nannofossil study stretch on an interval of approximately 16 years and it was one of the main pillars in the hydrocarbon research field at that time being. This work brings out the most important results achieved on calcareous nannofossil biostratigraphy, starting from 1982 to present. Such as, the main research areas were the Pre-Adriatic Depression and Ionian Zone, from where several biozones belonging to Cenozoic were described. The most recent studies on the Albanian – Thessalian Basin molassic sediments improve the general biostratigraphical framework and bring out new data on calcareous nannofossils paleoecology and palaeoenvironment.

Keywords: historical background, calcareous nannofossils, biostratigraphy, micropaleontology, Albania.

INTRODUCTION

The calcareous nannofossils' study is an important scientific branch in micropaleontology and biostratigraphy and has applicability in the hydrocarbon and gas industry. Their biostratigraphical potential was first realized in 1950 and started with studies on Cenozoic sediments (Bown & Young 1998).

The calcareous nannofossils' group spans an interval from late Triassic to recent, and include microfossils formed of calcium carbonate smaller than 63 µm in size, excluding fragments and juveniles' forms of other larger fossils. They belong to Coccolithophore group (division Haptophyta; Lohmann 1902), and according to their morphology, mode of formation and the life – cycles stage, they can be separated in: heterococcoliths, holococcoliths (Braarud et al. 1955a, 1955b.) and nannoliths (Young et al. 1994, 1999). This group

display biogeographical distribution, being more diverse at low latitudes, while they are not found above 70° at higher latitude. They can be found in eutrophic, mesotrophic and oligotrophic environments and their worldwide distribution is connected to sea water temperature, nutrient distribution, oceanic circulation, upwelling and seasonal mixing, salinity and water carbonate content etc.

During the last decades, important data dealing with material from on-land and oceanic sections all over the world were collected, and several biostratigraphical schemes were compiled and improved for both Mesozoic and Cenozoic eras. The calcareous nannofossil based biostratigraphy is currently improved with the support of various tools, such as: magnetostratigraphy, cyclostratigraphy, isotope stratigraphy and correlation to other microfossil groups. The

¹Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Tirana
Email: madalina_kallanxhi@yahoo.com

integration of all these methods and data allowed a better biochronology and calibration of calcareous nannofossil bioevent.

The goal of this article is to bring out the existing knowledge on this topic in Albania since its beginnings, to point out the calcareous nannofossils importance in hydrocarbon industry, and in activities related to mapping, sedimentology and stratigraphy.

GEOLOGICAL SETTING

The calcareous nannofossil investigations in Albania span and interval of around 16 years and were initiated within the oil and gas research framework by the Oil and Gas Institute Fier (Albania), during the '80-es. These investigations were concentrated mainly on the terrigenous sediments (flysch and molasses) of the Ionian Zone and Pre-Adriatic Depression (Fig. 1), and less in Albanian – Thessalian Basin (ATHB), Kruja, Mirdita, Sazani and Krasta – Cukali tectonic zones.




sedimentare që kalonte pusi. Nga metodat gjeokimike që u përdorën, u përcaktuan sasia, tipi dhe pjekuria e lëndës organike si dhe karakteristikat gjeokimike të gazeve hidrokarburë.

NDËRTIMI GJEOLOGJIK

Rajoni Fortuzaj shtrihet në sektorin verior të rrudhosjes flishore Papër – Rovë – Fortuzaj (Fig. 1), i cili sipas studimeve ekzistuese, është konkluduar

se ky rajon përfaqëson vazhdimin më verior të zonës Jonike. Pusi Fortuzaj-2 ka takuar prerjen e Burdigalianit, Akuitanianit dhe Oligocenit të sipërm. Këndi i rënies së shtresave është i madh dhe kjo shpjegon faktin që megjithëse thellësia e shpimit është e madhe, pusi ka kaluar një prerje të reduktuar sedimentare. Kolona litologjike që përshkoi pusi Fortuzaj-2 paraqitet në figurën 2.




Figura 1. Harta gjeologjike skematike e rajonit Fortuzaj (sipas Xhomo et al. 2002).

Në përshkrimin litologjik nuk do të përfshihet e gjithë prerja sedimentare e rajonit, por vetëm ajo që ka kaluar pusi Fortuzaj-2 (Fig. 2).

Depozitimet e Paleogjenit

Oligoceni i sipërm (Pg_3^3)

Këto depozitime takohen vetëm në brezin flishor Papër – Rovë – Fortuzaj të cilin e konsiderojmë vazhdim të zonës tektonike Jonike. Litologjikisht përfaqësohen nga ndërthurje flishi argjilo – ranor me horizonte vithisë, ranorë të trashë deri masivë e konglomeratë. Karakteristike është prania e shtresave gëlqeroro – ranorike të cilët përgjithësisht takohen në tavan të horizonteve vithisë. Trashësia e Oligocenit të sipërm varion nga 500 m deri 1100 m, ndërsa në pusin Fortuzaj-2 këto depozitime takohen në thellësinë 3160 m.

Depozitimet e Neogjenit

Në këto depozitime është veçuar vetëm seksioni Miocenik. Në depozitimet këtij seksioni u dallua nënseksioni i Miocenit të poshtëm me depozitime Burdigaliane dhe Burdigaliane.

Akuitanian (N_1^1a)

Këto depozitime kanë përhapje shumë të kufizuar. Në pusin Fortuzaj-2 takohen në intervalin 2320 – 3160 m me kënde të mëdhenj (rreth 60°) gati drejt perëndimit. Përgjithësisht përfaqësohen nga ndërthurje flishore argjilo – alevrolito – ranore, me horizonte të rrallë vithisë. Prerja përbëhet nga një flish i hollë argjilo – ranor i pasur me foraminifere planktonike si: Globigerina trilocularis, G. venezuelana, G. woodi, Globigerinoides primordius dhe Globoquadrina dehiscens, të cilat i përkasin zonës

faunistike me Globoquadrina dehiscens tipike për Akuitanianin (Yzeiraj et al. 2004). Duke parë me kujdes prerjen në terren, nuk vërehen diskordanca këndore apo azimutale dhe nga ana tjetër nuk takohet faunë e re që të quhet si bazë trasgresioni e Burdigalianit. Por, nga ana tjetër edhe mungesa e faunës neogjenike, karakteristike për Akuitanianin, tregon se prania e këtyre depozitimeve duhet vënë në dyshim. Duke e parë problemin në kompleks jemi të prirur të zgjidhje përfundimtare të argumentuar këtij problemi, në hartën gjeologjike të paraqitur, këto depozitime janë lënë si të Akuitanianit. Trashësia e këtyre depozitimeve në prerjet e studiara varion nga 50 në 120 m, ndërsa në shpim kapen nga 2320 m deri në 3160 m.

Burdigaliani (N_1^1b)

Depozitimet e Burdigalianit kanë përhapje relativisht më të madhe se ato të Akuitanianit. Në jug, mbi strukturat e zonës Kruja këto depozitime vendosen trasgresivisht mbi depozitimet më të vjetra, deri afër shkëmbinjeve gëlqerorëve. Litologjikisht përfaqësohen nga mergele, argjila mergelore, alevrolite dhe gëlqerorë litotamnike me makroforaminifere. Në fushëpërhapjen e tyre është shpuar pusi Fortuzaj-2, me objekt kapjen e nivelit të gëlqerorëve. Ky nivel nuk u takua dhe pusi mbeti në depozitimet e Oligocenit të sipërm (Yzeiraj et al. 2004). Nga ana tektonike, blloku flishor Rovë – Fortuzaj është një njësi antiklinale nën mbihypjen e zonës tektonike të Krujës. Ky fakt është përcaktuar nga studimet e fundit të kryera në këtë rajon (Dorre et al. 2004; Prifti & Dorre 2009).

Kolona litologjike	Intervall (m)	Mosha gjeologjike	Përshkrimi litologjik
	0 - 2320	N ¹ /b	Burdigalian (N ¹ /b). Mergele, argjila mergele, alevrolite dhe gëlqerorë litotamnike, me kënd të madh rënie.
	2320 - 3160	N ¹ /a	Akuitanian (N ¹ /a). Ranorë, alevrolite, argjila dhe konglomerate, me kënd të madh rënie.
	3160 - 4505	Pg ³	Oligocen i sipërm (Pg ³). Flish argjilo-ranor me shtresa gëlqerorësh, ranore masive, me kënd të madh rënie.

Figura 2. Kolona litologjike e pusit Fortuzaj-2.

METODOLOGJIA

Metodat e studimit i janë përshtatur natyrës së kampioneve të marra gjatë procesit të shpimit të pusit. Kampionet që ju nënshtrohen studimeve gjeokimike janë: coprat e shllamit, kampione të marrë nga kolona e shpimit dhe mostrat e shfaqjeve të gazit. Gama e metodave gjeokimike që aplikohen në prerjet gjeologjike të kapura nga pusët e shpimit është e madhe, por në këtë artikull do të trajtohen vetëm dy: metoda pirolitike (ose analiza "Rock-eval") dhe metoda e studimeve gaskromatografike të shfaqjeve të gazit të takuar në pus gjatë procesit të shpimit.

Metoda pirolitike, ose analiza "Rock-eval", është metodë bazë ku përcaktohet evolucionin i shkëmbit gjatë rritjes së programuar të temperaturës. Procedura përcaktuese është e bazuar në katër cikle pirolitike ku përcaktohen parametrat e mëposhtëm:

- Sasia e hidrokarbureve të lirë gazorë në mostrën e studiuar, tokë ose shkëmb (S_0 = mg.HK/g. shkëmb);
- Sasia e hidrokarbureve të lirë të

lëngët në mostrën e studiuar, tokë ose shkëmb (S_1 = mg.HK/g. shkëmb);

- Sasia e hidrokarbureve të gjeneruar gjatë procesit termik në mostrën e studiuar, tokë ose shkëmb (S_2 = mg.HK/g.shkëmb);
- Temperatura maksimale në °C ku ndodh gjenerimi i hidrokarbureve (S_2), e cila shprehet në T_{max} dhe gjykohet për nivelin e pjekurisë;
- Përmbajtja e lëndës organike, e shprehur me Karbonin Organik Total (TOC);
- Indeksi i hidrogjenit, që shpreh cilësinë e lëndës organike ($HI=S_2/TOC \cdot 100$);
- Indeksi i produktivitetit ($PI=(S_1/S_2)$).

Metoda gaskromatografike është metoda kryesore që aplikohet për të përcaktuar përbërjen hidrokarbure të gazeve natyrorë për diapazonin metan në normal heptan (C_7H_{16}). Gjithashtu përcaktohen edhe format izomere dhe hidrokarburet e pan-

gopur (C_nH_{2n}). Rezultatet e analizave paraqiten edhe grafikisht me anë të gaskromatogramave. Kjo metodë realizohet me anë të aparatit "Gaskromatograf".

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Rezultatet e analizës pirolitike të nxjerra me aparatit "Oil Show Analyser" në formë tabele, paraqiten më poshtë (Tab. 1).

Tabela 1. Rezultatet e analizës pirolitike në prerjen gjeologjike të përshkruar nga pusi Fortuzaj-2.

Nr.	Thellësia (m)	Mosha (kate)	Treguesit e analizës "Rock-eval"						
			S_0	S_1	S_2	T_{max}	TOC	HI	PI
1	559,00	N ¹ /b	0	0	0,36	431	0,25	144	0
2	788,00	N ¹ /b	0	0,03	0,96	425	0,53	181	0.03
3	1173,00	N ¹ /b	0	0	0,21	431	0,29	72	0
4	1427,50	N ¹ /b	0	0	0,13	433	0,19	68	0
5	1614,00	N ¹ /b	0	0	0,34	431	0,34	100	0
6	1864,50	N ¹ /b	0	0	0,38	433	0,35	108	0
7	2139,00	N ¹ /b	0	0	0,07	433	0,15	46	0
8	2321,00	N ¹ /a	0	0,02	0,35	431	0,27	129	0.054
9	2728,00	N ¹ /a	0	0,06	0,53	427	0,33	160	0.101
10	2852,50	N ¹ /a	0	0	0,2	431	0,2	100	0
11	2890,00	N ¹ /a	0	0	0,31	430	0,24	129	0
12	2945,00	N ¹ /a	0	0	0,34	430	0,25	136	0
13	2975,00	N ¹ /a	0	0	0,26	431	0,27	96	0
14	3045,00	N ¹ /a	0	0	0,27	432	0,21	128	0
15	3080,00	N ¹ /a	0	0	0,36	431	0,32	112	0
16	3165,00	Pg ³	0	0	0,31	433	0,32	96	0
17	3205,00	Pg ³	0	0	0,31	434	0,28	132	0
18	3360,00	Pg ³	0	0	0,41	434	0,36	113	0
19	3415,00	Pg ³	0	0	0,31	432	0,34	91	0
20	3530,00	Pg ³	0	0	0,27	435	0,29	93	0

Mbështetur në këtë metodë përcaktohen veçoritë gjeokimike të lëndës organike të takuar në prerjen gjeologjike që ka kaluar pusi Fortuzaj-2 (Priiti 1987). Mostrat e gazit janë analizuar me metodën gaskromatografike ku është përcaktuar përbërja hidrokarbure e tyre (Tabela 2).

Shfaqjet e gazit janë takuar në prerjen gjeologjike të Akuitanianit (N¹/a)

dhe në ato të Hatianit (Pg³). Rezultatet e marra me metodën pirolitike (ose analiza "Rock-eval") me anë të aparatit "Oil Show Analyser", interpretohen për të përcaktuar:

- 1.Përmbajtjen sasiore të lëndës organike e shprehur në karbonin organik total (%);

2. Tipin e lëndës organike, ose cilësi-
në e saj;
3. Pjekurinë e lëndës organike;
4. Lëndën organike të lirë të përfaqë-
suar nga hidrokarburet;
5. Produktet e kringizimit termik të
lëndës organike.

Tabela 2. Përbërja hidrokarbure e shfaqjeve të gazit në pusin Fortuzaj-2.

Intervali (metër)	Përbërja hidrokarbure e shfaqjeve të gazeve në pusin Fortuzaj-2 (%volumi)								
	CH ₄	C ₂ H ₆	C ₃ H ₈	iC ₄ H ₁₀	nC ₄ H ₁₀	iC ₅ H ₁₂	nC ₅ H ₁₂	SC6	SC7
2789.5	96.554	0.766	0.175	0.019	0.019	0.008	0.004	0.006	0.004
3893.6	96.778	0.641	0.32	0.028	0.015	0.006	0.004	0.011	0.011
3902.5	88.989	3.969	1.467	0.313	0.821	0.548	0.763	0.919	0.508
3909	99.773	0.203	0.024						

Sasia e lëndës organike

Sasia e lëndës organike është përcaktuar nga piroliza e mostrave shkëmbore nëpërmjet aparatit "Oil Show Analyser" (Tabela 1). Kështu, depozitimet e Burdigalianit kanë përbajtje të lëndës organike që luhet në diapazonin 0.15÷0.53 (Tabela 1), depozitimet e Akuitanianit kanë lëndë organike nga 0.25% deri 0.33%, ndërsa

në depozitimet e Oligocenit të sipërm (Hatiani) përbajtja e lëndës organike luhet nga 0.28÷0.36% (Fig. 3). Nga sa u diskutua më sipër arrijmë në përfundimin që prerja e kaluar nga pusi është e varfër në përbajtje të lëndës organike.




Figura 3. Përbajtja e lëndës organike (TOC) dhe potenciali gjenetik mbetës (S₂) në prerjen e kaluar nga pusi Fortuzaj-2.

Tipi i lëndës organike (Klasifikimi i lëndës organike sipas parametrave pirolitikë)

Duke u mbështetur në treguesit pirolitikë të përshkruar më sipër, realizohet klasifikimi i lëndës organike (Fig.

4). Duke u bazuar në karbonin organik total dhe në potencialin gjenetik mbetës ndahen pesë tipe gjeokimike të lëndës organike të paraqitur në në figuren 4: A – Shume e varfër; B – Varfër; C – Mjaftueshem; D – Mirë dhe E – Shumë e mirë.




Figura 4. Tipet gjeokimike të lëndës organike sipas TOC dhe S₂.

Në bazë të treguesve pirolitikë (me aparatit Rock-eval) realizohet edhe një klasifikim tjetër duke u mbështetur në indeksin e hidrogjenit HI (Fig. 5). Në këtë mënyrë përcaktohen tipet

potencialë të lëndës organike, pra se çfarë janë të aftë të gjenerojnë, naftë, naftë e gaz ose vetëm gaz (Prifti 1987). Ky klasifikim është shprehur në tabelën 3 dhe figurën 5.

Tabela 3. Rezultatet e analizës pirolitike në prerjen gjeologjike të përshkruar nga pusi Fortuzaj-2.

Tipet potencial të lëndës organike	Indeksi i hidrogjenit	Potenciali gjenetik mbetës (S ₂ =mg.HK/g.shk.)
I. Gjeneron naftë	> 300	> 10
II. Gjeneron gaz e naftë	200 ÷ 300	5 ÷ 10
III. Gjeneron gaz hidrokarbur	50 ÷ 200	1 ÷ 5




Figura 5. Indeksi i hidrogjenit dhe tipet e lëndës organike në prerjen e pusit Fortuzaj-2.

Bazuar në vlerat e parametrave pirolitike, lënda organike e prerjes gjeologjike të kaluar nga pusi Fortuzaj-2, është e tipit të tretë, e aftë të gjenerojë gaz hidrokarbur. Prerja më e thellë ka potencial më të lartë pasi është më e pjekur (Muskat & Prifti 1991).

Pjekuria e lëndës organike

Pjekuria e lëndës organike në prerjen e pusit Fortuzaj-2 është vlerësuar me anë të dy treguesve gjeokimikë: treguesi pirolitik Tmax dhe indeksi i produktivitetit.

Temperatura maksimale (T_{max})

Siç është përshkruar më sipër temperatura maksimale (T_{max}) në prerjen e pusit Fortuzaj-2 (Fig. 6) luhet në diapazonin 425 – 435 °C. Këto vlera tregojnë se lënda organike është e pamaturuar pranë hyrjes për në dritaren e naftës. Interpretimi i këtij treguesi jepet në figurën 5, ku deri në 435°C është stadi i pamaturuar, 435 ÷ 465 °C lënda organike është e

maturuar dhe përshihet në dritaren e naftës, ndërsa kur kalon vlerën 465°C përfshihet në stadin e tejmatuar.

Vlerësimi i pjekurisë sipas indeksit të produktivitetit (PI).

Indeksi i produktivitetit vlerësohet në sasinë e naftës të takuar në mostrat shkëmbore (S_1) dhe në sasinë e naftës që do prodhojë lënda organike (S_2), indeksi i produktivitetit: $PI = S_1 / (S_1 + S_2)$. Duke u bazuar në indeksin e produktivitetit përcaktohet niveli i pjekurisë së lëndës organike të takuar në prerjen Miocenit të poshtëm dhe Hatianit. Ky raport është vlerësuar vetëm në tre intervale: në thellësinë 788 m ku ka vlerën prej 0.003 dhe në thellësinë 2321 m ku ka vlerën 0.054, lënda organike është e pamaturuar; ndërsa në thellësinë 2728 m ku ka vlerën 0.101, lënda organike është e maturuar. Prerja e kaluar nga pusi ka një tendencë rritje të indeksit të produktivitetit (PI) me thellësinë. Prerja gjeologjike më thellë se 4500 m ka hyrë në dritaren e naftës. Indeksi i produktivitetit korrelohet edhe

me Tmax. Prerja më e vjetër dhe më e thellë shpreh tendencën e rritjes së pjekurisë me thellësinë. Kështu mund të priten shtritime të gazit natyror.

Hidrokarburet e gaztë

Në prerjen e kaluar nga pusi Fortuzaj-2 ka patur shfaqje të hidrokarbureve të gaztë. Bazuar në raportet Metan/Etan dhe Metan/Etan+ janë

përcaktuar tipet gjeokimike të gazeve hidrokarburë të shfaqur në prerjen e kaluar nga pusi Fortuzaj-2 (Tab. 4; Fig. 7). Gazi i marrë në thellësinë 3902.5 m është i tipit yndyror dhe i gjeneruar nga prerja gjeologjike më e thellë. Kurse tre mostrat e tjera janë gaze hidrokarburë të tipit shumë të thatë, të cilat janë të gjeneruar nga vet prerja sedimentare që ka kaluar pusi (Prifti 1987).




Figura 6. Pjekuria e lëndës organike në prerjen e pusit Fortuzaj-2 sipas T_{max} dhe indeksit të Produktivitetit (PI).

Tabela 4. Raportet e përbërjes së hidrokarbureve të gaztë në pusin Fortuzaj-2.

Intervali (metër)	Raportet e përbërjes së hidrokarbureve të gaztë në pusin Fortuzaj-2						
	iC ₄ nC ₄	C1/C2	C1/C2+	Wh	Bh	cH	C2/C3
2789.5	1	126.050	96.458	1.016	432.533	0.286	4.377
3893.6	1.867	150.980	114.125	0.846	526.589	0.402	4.856
3902.5	0.381	22.421	9.560	8.136	23.762	1.667	2.706
3909		491.493	439.529				




Figura 7. Tipet gjeokimike dhe pjekuria e gazeve hidrokarbur në pusin Fortuzaj-2

Nivelin e pjekurisë e kemi vlerësuar me raportin iC_4/nC_4 ky raport merr vlerat nga 0.38 deri në 1.86. Për vlera më të vogla se 1.0 gazi është i maturuar (i pjekur) dhe është i migruar nga prerja më e thellë dhe kjo e rrit shumë perspektivën e kërkimeve të shtritimeve të gazit në prerjet më të thella.

Vlerësimi i fluidmbajtjes në pusin Fortuzaj-2.

Treguesit gjeokimikë të përcaktuar në gazin e marrë në grykën e pusit Fortuzaj-2 për vlerësimin e fluidmbajtjes janë si më poshtë:

- Raporti Metan/Etan- C_1/C_2
- Raporti Metan/Etan + $= C_1/(C_2+C_3+C_4+C_5)$
- Raporti i yndyritetit (Wh), $Wh = (C_2+C_3+iC_4+nC_4+iC_5+nC_5)/(C_1+C_2+C_3+iC_4+nC_4+iC_5+nC_5) \cdot 100$
- Raporti i Balancës hidrokarbure: $Bh = (C_1+C_2)/C_3+iC_4+nC_4+iC_5+nC_5$
- Raporti karakterit hidrokarbur: $Ch = (iC_4+nC_4+iC_5+nC_5)/C_3$
- Raporti Etan/Propan = C_2/C_3

Kur raporti i yndyritetit (Wh) është me i vogël se 0.5, fluidmbajtja është jo produktive, kur është midis 0.5 dhe 7.5, konsiderohet gazmbajtës. Në pusin Fortuzaj-2 luhartet në intervalin 0.85 – 8.14 fakt që tregon se prerja më e thellë ka interes për gazra hidrokarbure.

Raporti i balancës hidrokarbure (Bh) është parametër që ulet kur rritet densiteti i fluidit në rezervuar. Në prerjen e kaluar nga pusi Fortuzaj-2 ka vlera të larta dhe luhartet në intervalin 23.8 – 526.6. Pra prerja e kaluar nga pusi ka interes për shtritime gazi hidrokarbur.

Raporti i karakterit hidrokarbur (Ch) ka vlera të ulëta (0.4 – 1.6) dhe tregon për prerje gazmbajtëse.

Kur raporti C_2/C_3 ka vlerat e larta (>2), tregon për prerje gazmbajtëse.

Mbështetur në këto parametra, gazi hidrokarbur i pusit Fortuzaj-2 e ka origjinën nga depozitimet e prerjes litologjike të kapur nga pusi. Prerja më e thellë mund të interpretohet me interes për kërkimin e shtritimeve të gazeve hidrokarbur.

PËRFUNDIME

Pusi Fortuzaj-2 është pusi më i thellë që është shpuar në rajonin e Tiranës. Detyra e pusit ka qenë kërkimi për shtritime nafte në prerjen karbonatike, detyrë që nuk u realizua dhe pusi mbeti në depozitimet flishore e flishoidale në thellësinë 4505 m. Prerja gjeologjike përfaqësohet nga depozitime me moshë Burdigaliane, Akuitaniane dhe Hatiane, dhe kanë kënde rënie të mëdhenj. Treguesit pirolitikë (analiza “Rock-eval”) evi-

dentojnë që prerja e kapur nga pusi është e varfër në lëndë organike e tipit të tretë, e aftë të gjenerojë hidrokarburë të gaztë të natyrës së thatë. Gazi hidrokarbur i marrë në thellësinë 3902.5 m është me origjinë nga prerja me e thellë, gjë që rrit perspektivën për kërkimet hidrokarbure. Rezultatet e përfituara nga pusi Fortuzaj-2 ndihmuan në prognozimin e një strukture antiklinale në lindje e quajtur “Antiklinali i Saukut”.

REFERENCAT

- XHOMO A., KODRA A., DIMO LL., XHAFI Z., NAZAJ SH., NAKUÇI V., YZEIRAJ D., LULA F., SADUSHI P., SHALLO M., VRANAJ A. & MELO V. (2002). Harta Gjeologjike e Shqipërisë, shkalla 1:200 000. *Arshiva e AKBN-së, Fier*.
- DORRE P., SILO V., THOMAI L., MYFTARI S. & MUSKA K. (2004). Studim gjeologjiko – gjeofizik i rajonit Veriu i Dumres – Papër – Rovë – Fortuzaj për evidentimin e strukturave me perspektivë naftë – gazmbajtëse. Raport shkencor, *Arshiva e AKBN-së, Fier*.
- PRIFTI I. & DORRE P. (2009). Evidentimi i strukturave karbonatike me perspektivë naftëgazmbajtëse të zonës Jonike nën mbihipjen e zonës Kruja në rajonin veriu i Dumres – Rovë – Fortuzaj. *Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr.1/2009*.
- PRIFTI I. (1987). Konkluzionet gjeokimike të pusit Fortuzaj-2. Dosja e pusit Fortuzaj-2. *Arshiva e AKBN-së, Fier*.
- MUSKA K. & PRIFTI I. (1991). Vlerësimi gjeokimik i depozitimeve flishore e flishoidale në rajonin Papër – Rovë – Fortuzaj. *Arshiva e AKBN-së, Fier*.
- YZEIRI D., SILO V. & BERBERI A. (2004). Stili tektonik i zonës tektonike Kruja nga Elbasani deri në Murriqan dhe vazhdimi i zonës tektonike nën të. Raport shkencor i projektit, *Arshiva e AKBN-së, Fier*.

APPLICATION OF PYROLYTIC AND GAS CHROMATOGRAPHIC DETERMINATIONS IN FORTUZAJ-2 BOREHOLE

ENKELA NOÇKA^{1*}, ILVA GJIKAJ¹ & GJON RROTA²

¹Polytechnic University of Tirana, Faculty of Engineering, Mathematical and Physical, Department of General and Inorganic Chemistry, Tirana, Albania.

²Polytechnic University of Tirana, Institute of Geosciences, Department of Geology, Tirana, Albania.

*Corresponding author: eninocka@yahoo.com

(Manuscript submitted in June 2022; accepted for publication in November 2023)

ABSTRACT

This article analyses the results obtained from the study of sedimentary logging data of the Fortuzaj – 2 borehole, through pyrolytic ("Rock-eval" analysis) and gas chromatographic methods. The sedimentary succession spanned by this borehole is represented by Chattian (upper Oligocene), Aquitanian and Burdigalian deposits. Geochemical analyses were conducted on samples from slurry, drilling cuts and gas. The investigated borehole, although the deepest, it got stuck in the upper Oligocene flysch and didn't meet the oil beds. Due to the fact this was the only drilling in the Albanides where gas emissions were found in the upper Oligocene flysch, it was considered quite important to study the existing data taken from the borehole through the above mentioned methods. This study highlights the values of the hydrocarbon generating potential treated with the "Rock-eval" analysis, and the origin of the gas occurrences at the depth of 3902.5 meters of this borehole. Through the two geochemical methods applied within this study, it was determined the amount, type and maturity of the organic matter, as well as the geochemical characteristics of the hydrocarbon gases appearing in the borehole, which turned out to be mature and of the fatty type.

Keywords: pyrolysis, Fortuzaj-2 borehole, organic carbon, hydrogen index, isomerization ratio.

INTRODUCTION

The study of the Fortuzaj-2 borehole was undertaken for the following reasons: this was the deepest borehole ever drilled in the Tirana region and it did not solve the task for which it was drilled, which was the capture of oil deposits in the carbonate section. The drilling got stuck in the upper Oligocene flysch deposits. This is the only borehole in the Albanides where mature hydrocarbon gas emissions were documented within the upper Oligocene interval, at a depth of 3902.5 m.

For this study, it was determined initially the hydrocarbon forming potential of the Fortuzaj-2 borehole section and it was also concluded that the gas occurrence at a depth of 3902.5 m must have originated from

the deepest part of the section.

The oil and gas exploration are being oriented on the overthrust front and under it, in the deepest parts of sedimentary deposits, with high generation potential due to the level of maturity. These two factors had been taken into account for the design and drilling of the Fortuzaj-2 borehole. During the drilling of the borehole there were recorded gas emissions which created problems for the drilling works advancing into the deeper part. These problems encouraged the geochemical study of the sedimentary succession. The application in this study of the chosen geochemical methods supported the identification of the amount, type and maturity of the organic matter, as well

¹UPT, FIME, Tirana; ²UPT, IGJEO, Tirana
e-mail: eninocka@yahoo.com

as the geochemical characteristics of the hydrocarbon emissions.

GEOLOGICAL SETTING

The Fortuzaj region is located in the northern sector of the Papër – Rovë – Fortuzaj area (Fig. 1), which according to the existing studies, it was concluded that this region represents the northernmost continuation of

the Ionian zone. The Fortuzaj-2 borehole cross sediments of Burdigalian, Aquitanian and upper Oligocene ages. The dipping angle of the layers is big and this explains the fact that although the drilling reaches high depths, the well passed through a reduced sedimentary succession regarding its age. The lithological column crossed by the Fortuzaj-2 borehole is shown in figure 2.



Figure 1. Geological map of Fortuzaj area (after Xhomo et al. 2002).

The lithological description will not include the entire sedimentary succession of the region, but only that intersected by the Fortuzaj-2 borehole (Fig. 2).

Paleogene deposits

Upper Oligocene (Pg₃)

These deposits are found only in the Papër – Rovë – Fortuzaj flysch belt, which it's considered the continuation of the Ionian tectonic zone. Lithologically, they are represented by a flyschoidal sequences with claystones and sandstones, intercalated locally with thick beds of massive sandstones and conglomerates. Characteristic is the presence of limestone – sandstone layers, which are generally located in the ceiling of the collapsed horizons. The thickness of the upper Oligocene varies from 500 m to 1100 m, while in Fortuzaj-2 well, these deposits were met at a depth of 3160 m.

Neogene deposits

The only Neogene sediments identified in the borehole are those of early Miocene age, more precisely the Aquitanian and Burdigalian ages.

Aquitanian (N₁^a)

These deposits have very limited distribution. In the Fortuzaj-2 borehole, they were met in the interval 2320 – 3160 m, at high dipping angles (about 60°) and almost western orientation. Generally, they are represented by flyschoidal succession of claystones, siltstones and sandstones, with rare intercalated horizons. In general, the section consists of thin laminated claystones – sandstones flysch, rich in planktonic foraminifera such as: *Globigerina trilobularis*, *G. venezuelana*, *G. woodi*,

Globigerinoides primordius and *Globoquadrina dehiscens*, which belong to the *Globoquadrina dehiscens* zone typical for the Aquitanian age (Yzeiraj et al. 2004). Looking carefully at the section in the field, no angular or azimuthal discordances were observed, also no new fauna was found that can indicate this is the base of the Burdigalian transgression. But, on the other hand, the lack of Neogene fauna, characteristic for Aquitanian, shows that the presence of these deposits should be doubted. Considering the complexity of the problem, it is assumed that the Aquitanian deposits from Petrela and further to the north were washed away. By not giving another solution regarding the age of these deposits, on the present geological map they are considered as Aquitanian. The thickness of these deposits in the studied sections varies from 50 m to 120 m, while in the borehole they were found between 2320 m and 3160 m.

Burdigalian (N₁^b)

The Burdigalian deposits are more widespread than those of Aquitanian age. In the southern part of the area, they overlay transgressively the structures of Kruja zone, and reach quite close to the limestone sediments. Lithologically, they are composed of marlstones, marly claystones, siltstones and lithothamnian limestones with macroforaminifers. The Fortuzaj-2 borehole was drilled in this area with the goal to reach the limestone level. This level was not met and the borehole got stuck in the upper Oligocene deposits (Yzeiraj et al. 2004). Tectonically, the Rovë – Fortuzaj flyschoidal block represents an anticlinal unit located below the Kruja tectonic zone. This fact has been determined by the latest studies carried out in this region (Dorre et al. 2004; Prifti & Dorre 2009).




Figure 2. Lithological column of the Fortuzaj-2 borehole.

METHODOLOGY

The methods applied within this study were selected in accordance with the type of samples collected during the drilling process. The samples which were subjected to geochemical analyses were as below: pieces of slag (core sludge), core samples (taken with a sampler) and gas samples. The range of geochemical methods that are applied to various geological sections within boreholes is quite wide, but for this study were selected only two: the pyrolytic method (or "Rock-eval" analysis) and the gas chromatographic method for gas occurrences encountered in the borehole during the drilling process.

The *pyrolytic method*, or "Rock-eval" analysis, is a basic method that determines the evolution of the rock during the programmed increase in temperature. As a result, the applied procedure is based on four pyrolytic cycles where the following parameters are determined:

- The amount of free hydrocarbon gases in the studied sample, soil, or rock (S_0 = mg.HK/g.rock);
- The amount of free liquid hydro-

carbon in the studied sample, soil, or rock (S_1 = mg.HK/g.rock);

- The amount of hydrocarbon generated during the thermal process in the studied sample, soil, or rock (S_2 = mg.HK/g.rock);
- The maximum temperature in oC where the generation of hydrocarbons occurs (S_2), expressed as T_{max} and is categorized according to the level of maturity;
- The content of organic matter expressed as Total Organic Carbon (TOC);
- Hydrogen index which expresses the quality of organic matter ($HI = S_2 / TOC * 100$);
- Productivity index ($PI = S_1 / (S_1 + S_2)$).

The *gas chromatographic method* is the main method used to determine the hydrocarbon composition of natural gases within the methane to normal heptane (C_7H_{16}) range. Isomeric forms and unsaturated hydrocarbons (C_nH_{2n}) are also determined. The results of the analyses are also

presented graphically by means of gas chromatograms charts. This method is realized by using the "Gas chromatograph" device.

RESULTS AND DISCUSSIONS

The pyrolytic analysis results obtained with the "Oil Show Analyser" device are presented below (Tab. 1).

Table 1. The pyrolytic analysis results from the geological section crossed by the Fortuzaj-2 borehole.

No.	Depth (m)	Age (Stage)	"Rock-eval" analysis indicators						
			S_0	S_1	S_2	T_{max}	TOC	HI	PI
1	559,00	N ¹ b	0	0	0,36	431	0,25	144	0
2	788,00	N ¹ b	0	0,03	0,96	425	0,53	181	0.03
3	1173,00	N ¹ b	0	0	0,21	431	0,29	72	0
4	1427,50	N ¹ b	0	0	0,13	433	0,19	68	0
5	1614,00	N ¹ b	0	0	0,34	431	0,34	100	0
6	1864,50	N ¹ b	0	0	0,38	433	0,35	108	0
7	2139,00	N ¹ b	0	0	0,07	433	0,15	46	0
8	2321,00	N ¹ a	0	0,02	0,35	431	0,27	129	0.054
9	2728,00	N ¹ a	0	0,06	0,53	427	0,33	160	0.101
10	2852,50	N ¹ a	0	0	0,2	431	0,2	100	0
11	2890,00	N ¹ a	0	0	0,31	430	0,24	129	0
12	2945,00	N ¹ a	0	0	0,34	430	0,25	136	0
13	2975,00	N ¹ a	0	0	0,26	431	0,27	96	0
14	3045,00	N ¹ a	0	0	0,27	432	0,21	128	0
15	3080,00	N ¹ a	0	0	0,36	431	0,32	112	0
16	3165,00	Pg ³	0	0	0,31	433	0,32	96	0
17	3205,00	Pg ³	0	0	0,31	434	0,28	132	0
18	3360,00	Pg ³	0	0	0,41	434	0,36	113	0
19	3415,00	Pg ³	0	0	0,31	432	0,34	91	0
20	3530,00	Pg ³	0	0	0,27	435	0,29	93	0

Based on this method were identified the geochemical features of the organic matter encountered in the sedimentary succession crossed by the Fortuzaj-2 borehole are (Prifti 1987). The gas emissions were analysed by using the gas chromatographic method where their hydrocarbon composition was determined (Table 2).

The gas emissions occurred the Aqu-

tanian (N_1^1a) and Chattian (Pg_3^3) sediments. The data obtained with the pyrolytic method (or "Rock-eval" analysis) using the "Oil Show Analyser" are used to determine the following:

- 1.The amount of organic matter expressed in total organic carbon (%);

2. The type of organic matter, or its quality;
3. Maturity of organic matter;
4. Free organic matter represented by hydrocarbons
5. Products of the thermal cracking of organic matter.


Table 2. Hydrocarbon composition of gas occurrences in the Fortuzaj-2 borehole.

Interval (meter)	Hydrocarbon composition of gas occurrences in the Fortuzaj-2 borehole (%volume)								
	CH ₄	C ₂ H ₆	C ₃ H ₈	iC ₄ H ₁₀	nC ₄ H ₁₀	iC ₅ H ₁₂	nC ₅ H ₁₂	SC6	SC7
2789.5	96.554	0.766	0.175	0.019	0.019	0.008	0.004	0.006	0.004
3893.6	96.778	0.641	0.32	0.028	0.015	0.006	0.004	0.011	0.011
3902.5	88.989	3.969	1.467	0.313	0.821	0.548	0.763	0.919	0.508
3909	99.773	0.203	0.024						

The amount of organic matter

The amount of organic matter was determined by the pyrolysis of rock samples using the "Rock-eval" device (Table 1). Thus, the Burdigalian deposits exhibit a content of organic matter that fluctuates in the range of 0.15÷0.53 (Table 1). The Aquitanian deposits have quantities of organic


matter from 0.25 % to 0.33 %, while in the upper Oligocene deposits the organic matter content fluctuates from 0.28 % to 0.36 % (Fig. 3). These data suggest that these drilled sediments are quite poor in organic matter.

**Figure 3.** Total Organic Carbon content (TOC) and the residual genetic potential (S₂) in the section of Fortuzaj-2 borehole.

Type of organic matter (Classification of organic matter according to the pyrolytic parameters)

Based on the pyrolytic indicators described above, it was realized the classification of the organic matter

(Fig. 4). Based on the total organic carbon and the residual genetic potential, were divided five geochemical types of organic matter which are presented in figure 4: A - Very poor; B - Poor; C - Sufficient; D - Good and E - Very good.

**Figure 4.** Geochemical types of organic matter according to TOC dhe S₂.

Based on the pyrolytic indicators (with the Rock-eval device) another classification is made according to the HI hydrogen index. In this way, the types of organic matter and their hydrocarbon generating potential

were determined, such as their capability of generating oil, oil and gas, or only gas (Prifti 1987). This classification is presented in table 3 and figure 5.

Table 3. Geochemical types of organic matter according to HI.

Potential types of organic matter	Hydrogen index	Residual genetic potential (S ₂ =mg.HK/g.shk.)
I. Generates oil	> 300	> 10
II. Generates gas and oil	200 ÷ 300	5 ÷ 10
III. Generates hydrocarbon gas	50 ÷ 200	1 ÷ 5




Figure 5. Hydrogen index and types of organic matter in the Fortuzaj-2 borehole

Based on the values of the pyrolytic parameters, the organic matter of the investigated sediments crossed by the Fortuzaj-2 borehole is of the third type, capable of generating hydrocarbon gas. The deeper part of the section has higher potential as it is more mature (Muska & Prifti 1991).

Maturity of the organic matter

The maturity of the organic matter in the Fortuzaj-2 borehole was evaluated by means of two geochemical indicators, which are the pyrolytic indicator T_{max} and the productivity index.

Maximum temperature (T_{max})

As described above, the maximum temperature (T_{max}) in the Fortuzaj-2 borehole (Fig. 6) fluctuates in the range of 425 – 435 °C. These values show that the organic matter was not mature close to the entrance of the oil window. The interpretation of this indicator is given in figure 5, where up to 435 °C is the immature stage, between 435 and 465°C the organic matter is mature and it's included

in the oil window, while when it exceeds the value of 465 °C it is included in the over – mature stage.

Assessment of the maturity according to the productivity index (PI).

The productivity index is evaluated in the amount of oil found in the rock samples (S_1) and in the amount of oil that will produce organic matter (S_2), the productivity index: $PI = S_1 / (S_1 + S_2)$. Based on the productivity index it was possible to establish the maturity level of the organic matter encountered in the lower Miocene and Chattian sediments. This ratio has been evaluated in three intervals: at the depth of 788 m where it has a value of 0.003 and at the depth of 2321 m where it reaches the value of 0.054. The organic matter is immature. While at the depth of 2728 m, it reaches a value of 0.101 and it is considered mature. It was noticed a tendency of increase of the productivity index (PI) with the depth. The sediments deeper than 4500 m are in the oil window. The productivity index is also correlated with the

T_{max} . The organic matter exhibits a tendency to increase with the depth increase. Thus, natural gas it can be expected in this section.

Gaseous hydrocarbons

In the section of the Fortuzaj-2 borehole there were occurrences of gaseous hydrocarbons. Based on the Methane/Ethane and Methane/Ethane+ ratios, the geochemical types

of hydrocarbon gases appearing in the cross section from the Fortuzaj-2 borehole (Tab. 4; Fig. 7), were determined. The gas obtained at a depth of 3902.5m is of fatty type and generated from the deepest geological section. While the other three samples are hydrocarbon gases of a very dry type, which are generated by the sedimentary section crossed by the borehole (Prifti 1987).




Figure 6. Maturity of organic matter in the section of the Fortuzaj-2 borehole according to T_{max} and the Productivity Index (PI) .

Tabela 4. Hydrocarbon composition of gas occurrences in the Fortuzaj-2 borehole.

Interval (metër)	Hydrocarbon composition of gas occurrences in the Fortuzaj-2 borehole						
	iC_4, nC_4	C1/C2	C1/C2+	Wh	Bh	cH	C2/C3
2789.5	1	126.050	96.458	1.016	432.533	0.286	4.377
3893.6	1.867	150.980	114.125	0.846	526.589	0.402	4.856
3902.5	0.381	22.421	9.560	8.136	23.762	1.667	2.706
3909		491.493	439.529				




Figure 7. Geochemical types and maturity of hydrocarbon gases in the Fortuzaj-2 borehole .

The gases maturity was evaluated with the iC_4/nC_4 ratio, which reaches values from 0.38 to 1.86. For values smaller than 1, the gas is mature and has migrated from the deeper part of the section, and this fact increases the prospect of searching for gas deposits in the deepest sections.

Assessment of the fluid content in the Fortuzaj-2 borehole

The geochemical indicators determined in the gas sampled at the mouth of the Fortuzaj-2 borehole for the assessment of the fluid content are as follows:

- Metan/Etan ratio- C_1/C_2
- Metan/Etan ratio + = $C_1/(C_2+C_3+C_4+C_5)$
- Fat ratio (Wh), $Wh = (C_2+C_3+iC_4+nC_4+iC_5+nC_5)/(C_1+C_2+C_3+iC_4+nC_4+iC_5+nC_5) \cdot 100$
- Hydrocarbon Balance Report: $Bh = (C_1+C_2)/C_3 + iC_4+nC_4+iC_5+nC_5$
- Hydrocarbon character ratio: $Ch = (iC_4+nC_4+iC_5+nC_5)/C_3$

• Etan/Propan ratio = C_2/C_3

When the *Fat ratio* (Wh) is smaller than 0.5, there is no productivity, compared to when this ratio is between 0.5 and 17.5, and it's considered gas-bearing. In the Fortuzaj-2 borehole this parameter ranges between 0.85 and 8.14, which indicate the existence of hydrocarbon gas in the deeper part of this section.

Hydrocarbon balance report (Bh) is a parameter which decreases when the density of the fluid in the tank increases. In the cross section from the Fortuzaj-2 borehole, there are high values, and it is fluctuating in the range of 23.8 - 526.6. So, this borehole is of interest for hydrocarbon gas deposits investigations.

Hydrocarbon ratio (Ch) displays low values (0.4 - 1.6) and indicates a gas-bearing section.

When the ratio C_2/C_3 has high values (>2), indicates a gas-bearing section.

Based on these parameters, the hydrocarbon gas of the Fortuzaj-2 borehole originates from the sediments crossed by the well. The deeper sec-

tion can be considered with interest for the hydrocarbon gas exploration.

CONCLUSIONS

Fortuzaj-2 borehole is the deepest borehole that had ever been drilled in the region of Tirana.

The task of the borehole was to explore the oil deposits in the carbonate section, a task that was not accomplished since the borehole got stuck in the flysch deposits at the depth of 4505 m. The sedimentary succession is represented by Burdigalian, Aqu-

tanian and Chattian deposits which have sharp dipping angles. The pyrolytic indicators ("Rock-eval" analysis) indicated that the borehole is poor in organic matter, of the third type capable to generate fresh hydrocarbon of dry nature. The hydrocarbon gas taken at the depth of 3902.5 m originates from the deepest part of this section, and this fact increases the prospect for hydrocarbon exploration. The results obtained from the Fortuzaj-2 borehole were helpful for the prognosis of an anticline structure in the eastern part called the "Sauk Anticline".

REFERENCES

- XHOMO A., KODRA A., DIMO LL., XHAFA Z., NAZAJ SH., NAKUÇI V., YZEIRAJ D., LULA F., SADUSHI P., SHALLO M., VRANAJ A. & MELO V. (2002). Harta Gjeologjike e Shqipërisë, shkalla 1:200 000. *Arshiva e AKBN-së, Fier*.
- DORRE P., SILO V., THOMAI L., MYFTARI S. & MUSKA K. (2004). Studim gjeologjiko - gjeofizik i rajonit Veriu i Dumres - Papër - Rovë - Fortuzaj për evidentimin e strukturave me perspektivë naftë - gazmbajtëse. Raport shkencor, *Arshiva e AKBN-së, Fier*.
- PRIFTI I. & DORRE P. (2009). Evidentimi i strukturave karbonatike me perspektivë naftëgazmbajtëse të zonës Jonike nën mbijepjen e zonës Kruja në rajonin veriu i Dumres - Rovë - Fortuzaj. *Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr.1/2009*.
- PRIFTI I. (1987). Konkluzionet gjeokimike të pusit Fortuzaj-2. Dosja e pusit Fortuzaj-2. *Arshiva e AKBN-së, Fier*.
- MUSKA K. & PRIFTI I. (1991). Vlerësimi gjeokimik i depozitimeve flishore e flishore në rajonin Papër - Rovë - Fortuzaj. *Arshiva e AKBN-së, Fier*.
- YZEIRI D., SILO V. & BERBERI A. (2004). Stili tektonik i zonës tektonike Kruja nga Elbasani deri në Murriqan dhe vazhdimi i zonës tektonike nën të. Raport shkencor i projektit, *Arshiva e AKBN-së, Fier*.

STUDIM PARAPRAK PËR NJË MODELIM 3D TË TEKTONIKAVE SHKËPUTËSE

SOKOL MARKU^{1*}, ANXHELA DERVISHI¹ & IBA ÇAUSHI¹

¹Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Rruga Zef Serembe, Tiranë, Shqipëri

*Autori korrespondent: marku2s@yahoo.com

(Dorëshkrim i dorëzuar në gusht 2023; i pranuar për botim në nëntor 2023)

ABSTRAKT

Objekti i këtij artikulli ishte realizimi i një modeli gjeotektonik tredimensional (3-D) në zonën e Basenit të Adriatikut Jugor (BAJ) duke integruar të dhënat gjeologjike dhe sizmike, që të ndihmonë në vlerësimin gjeometrik të shkëputjeve dhe historisë tektonike të kësaj zone. Zona shtrihet nga Mali i Zi, në Shqipëri e deri në Greqi, dhe është zona ku zhvillohet aktiviteti më i lartë sizmik në vend duke qenë i karakterizuar nga shkëputje tektonike e të shumta, shumica e të cilave sizmoaktive. Sot në mbarë botën, zhvillimi teknologjik ka mundësuar automatizimin e krijimit të data bazave alfanumerike dhe dizajnit të këtyre të dhënave në formë grafike. Këto mundësi ofrojnë një paraqitje sa më pranë reale të ndërtimit gjeologjik në harta digjitale 3D. Artikulli është një përpyetje për studimin dhe trajtimin e paraqitjes në 3D të tektonikës, për pjesën detare, nga sipërfaqja drejt thellësisë, metoda e ndërtimit të saj në aspektin tredimensional duke u bazuar në të dhëna të cilat si pikënisje kanë tavanet moshorë, izolinjat dhe tin - et.

Fjalë kyçe: 3D, baseni i Adriatikut jugor, sizmike, shkëputje aktive, Serravalian, Tortonian, Mesinian, tektogjeneze, TIN, izolinja.

HYRJE

Aktiviteti i lartë sizmik dhe ngjarjet sizmike të cilat kanë karakterizuar vendin tonë, veçanërisht 3 – 4 vitet e fundit, kanë shtruar nevojën e një studimi më të thellë të të gjithë proceseve përgjegjëse për gjenerimin e tërmeteve dhe fenomeneve të tjera lidhur me to. Studiuesit shqiptarë kanë kryer një numër të madh studimesh në fushën e tektonikës, eksplorime gjeofizike dhe kërkime sizmologjike në të gjithë territorin shqiptar, duke përfshirë dhe BAJ. Kjo ka mundësuar grumbullimin e të dhënave origjinale të bollshme dhe të besueshme, por aktualisht, asnjë studiues nuk i ka përdorur këto të dhëna për të kryer një punim të detajuar të modelimit 3D të tektonikave të vendit. Integrimi i këtyre të dhënave shumëdisiplinore për të krijuar një model struktural gjeometrik 3D, që ka të bëjë me tektonikën sizmogjene, mund të jete një çelës për

kufizimin e vlerësimit rajonal të rrezikut sizmik me një numër të madh shkëputjesh tektonike aktive dhe aktivitet të shpeshtë sizmik.

Është i njohur fakti që territori shqiptar (Papa 2000) karakterizohet prej një numri të madh shkëputjesh tektonike aktive dhe nga një aktivitet i vazhdueshëm sizmik dhe për këtë arsye, këto kufij të blloqeve aktive (zona shkëputjesh tektonike të thella tërthore dhe gjatësore) janë elemente strukturore sizmogjenetike. Shkaku kryesor i aktivitetit sizmik në këto kufij është përplasja mes dy pllakave të mëdha: pllakës Euroaziatike dhe asaj Afrikane. Kjo e fundit luan një rol të rëndësishëm në zonën Adriatike, sepse si shkak i lëvizjeve të saj veriore brenda dhe afër territorit shqiptar, ajo ushtron stres dhe është përgjegjëse për aktivitetin sizmik në vendit tonë.

Një kategori tërmetesh kanë vatrë përgjatë bregdetit Jon dhe Adriatik dhe studimet tregojnë se përgjegjëse për tërmetet e Durrësit më 23 Shtator dhe 26 Nëntor dhe para e pas goditjet e tyre janë një sërë planesh tektonike, të cilët vendosen në pjesën bregdetare edhe detare të Shqipërisë (Doda et al. 2019, 2020). Për këtë fakt paraqitja e tektonikave në tokë dhe në det, njohja e lëvizjes dhe sjelljes së tyre në thellësi të mëdha, ku në përgjithësi lindin tërmetet, përbën një element kyç në përcaktimin e sjelljes së litosferës dhe rrezikut gjeologjik – sismik të lidhur me të. Mënyra se si të integrohen me efikasitet të dhënat gjeotektonike, gjeofizike dhe sismike për ta bërë këtë model sa më të afërt me realitetin përbën një sfidë parësore në lidhje me aplikimin e modelimit tridimensional i cili integron këto të dhëna me natyrë të ndryshme që e përmendëm më lart. Studimi më i detajuar bazuar në të dhëna stratigrafike, strukturore, gjeologjike - gjeofizike, përfshirë këtu dhe profilet sismike në tokë e det dhe të dhënat nga pusët e thella, gjithashtu do ndihmojë në njohjen më të mirë të marrëdhëniet mes zonave Kruja, Jonike e Sazani. Thellimi i studimeve mbi tektonikën mundëson një studim më të hollësishëm të ngjarjeve sismike.

NDËRTIMI GJEOLGJIK

Lëvizjet tektonike shpërndihen shoqërohen me çlirim të energjisë të blloqeve dhe janë përgjegjëse për lindjen e veprimtarisë sismike. Në hartën botërore të rrezikut sismik, bazuar në vlerat e akselerimit (g), Shqipëria ndodhet në zonën e kuqe, renditet në vendin e 43, duke e klasifikuar në grupin e vendeve që paraqesin risk të lartë sismik (Marku et al. 2014, 2021; Muço 1995; Ormeni & Marku 2009). Aktiviteti sismik në vend konsiderohet i moderuar, çka do të thotë që lëkundjet me magnitudë të mesme janë të shpeshta, dhe në mënyrë periodike ka lëkundje të forta dhe shumë të forta me pasojë të rënda (Marku et al. 2021). Për

parandalimin e rrezikut që vjen nga aktiviteti sismik duhen ndërmarrë studime në të cilat duhet të bazohemi për të hartuar kodet antisismike, të cilët përcaktojnë normat e ndërtimit në rajone të ndryshme duke marrë në konsideratë rrezikun sismik të çdo rajoni. Është e rëndësishme njohja e mirë e tektonikës, e cila na ndihmon në kuadër të këtyre studimeve të ndërtojmë hartat e makrozonimit dhe mikrozonimit sismik.

Sizmiciteti i vendit tonë është i lidhur me zonat sizmogjene të shpërndara në gjithë territorin e Shqipërisë. Gjatë katër dekadave të fundit janë propozuar katër modele sizmotektonikë, të cilët e kanë ndarë territorin në disa zona sizmogjene. Një model të ndarjes së territorit të vendit tonë në zona sizmogjene aktive jepet nga Aliaj et al. (2010). Një model fillestar u përcaktua nga Aliaj (2000) në Shqipëri, ku u evidentuan gjithsej gjashtë zona sizmogjene, nga të cilat, tre zona sizmogjene gjatësore ndërpritën kryq nga tri zona tërthore, respektivisht: zona sizmogjene gjatësore Joniano – Adriatike, Shkodër – Mat – Librazhd – Bilisht dhe Peshkopi – Korçë (zona e Drinit) dhe ato tërthore, Shkodër – Pejë, Lushnje – Elbasan dhe Vlorë – Tepelenë.

Një prej zonave me potencial sismik të lartë karakterizuar nga shpërndarje gjatësore sismoaktive është dhe zona e shpërndarjeve sismoaktive Joniano-Adriatike që shtrihet nga Mali i zi, nëpër Shqipëri e deri në Greqi. Në këtë zonë zhvillohet aktiviteti më i lartë sismik në vend. Përgjatë saj janë regjistruar disa tërmete të fuqishëm me intensitet në epiqendër $Io = VIII - IX$ ballë dhe magnitudë deri mbi 6.5.

Siç tregojnë studimet sismike, platforma që ndodhet në këto dete ndërtohet nga dy facie të ndryshme karbonatike: (a) një platformë e karakterizuar nga facie karbonatike të thella, e emërtuar si Baseni i Adriatikut Jugor (BAJ), që lokalizohet në veri të Sazanit, ose më saktë, në veri të tërthores Vlorë – Shkup me shtrirje

lindje-perëndim dhe në perëndim të Ultësirës Adriatike dhe (b) platforme karbonatike e facies së cekët, e quajtur platforma Apuliane, e cila shtrihet në jug të basenit të Adriatikut jugor dhe në perëndim të zonës gjeologjike Sazani. Kjo zonë karakterizohet nga shpërndarje tektonike të shumta, shumica e të cilave janë sismoaktive.

Në orogjenin shqiptar identifikohen tri zona gjatësore dhe dy zona tërthore të shpërndarjeve aktive kryesore që janë: 1) Zona Joniano – Adriatike e shpërndarjeve mbihipëse me shtrirje veriperëndimore (VP) deri afërsisht veri – veriperëndim (VVP); 2) Zona Shkodër – Mat – Librazhd e shpërndarjeve normale grabenore me shtrirje veriperëndim (VP); 3) Zona Peshkopi – Korçë e shpërndarjeve normale grabenore me shtrirje veri (V) – jug (J); 4) Zona Shkodër – Tropojë e shpërndarjeve normale me shtrirje verilindje (VL), dhe 5) Zona Lushnjë – Elbasan – Dibër e shpërndarjeve normale me shtrirje VL (Aliaj 2000).

Zona Joniano – Adriatike

Zona e shpërndarjeve sismoaktive Joniano-Adriatike, është një zonë që shtrihet për disa qindra kilometra përgjatë bregdetit Adriatik dhe Jon, karakterizohet nga shpërndarje mbihipëse dhe ndahet në tri segmente nëpërmjet tërthoreve Shkodër – Pejë dhe Vlorë – Tepelenë, si vijon:

1. Një segment verior me shtrirje V – VP i karakterizuar nga një zonë shpërndarje mbihipëse para – Pliocene të zonës Kruja (Dalmate) ende aktive edhe sot, i cili vazhdon mbi 200 km nga Lezha në Ulqin dhe më tej përgjatë bregdetit Dalmat.
2. Një segment qendror me shtrirje V deri V – VP, i karakterizuar nga shpërndarje post-Pliocene mbihipëse në shtypje oblike të Ultësirës Adriatike, që vazhdon për rreth 130 km nga Lezha deri në veri të Vlorës.
3. Një segment jugor me shtrirje VP,

i karakterizuar nga shpërndarje mbihipëse para-Pliocene, kryesisht të zonës Jonike, ende aktive edhe sot, që vazhdon për rreth 250 km, nga Vlorë në Konispol dhe më tej, përgjatë bregdetit Jonian, në Greqi.

- MARKU S., ORMENI R. & PANZA G. (2021).** Seismic characterization of Tirana - Durrës - Lezha region (northwestern Albania) and analysis effort through NSHA method. Earthquakes and Sustainable Infrastructure: neodeterministic (NDSHA) approach guarantees prevention rather than cure" (In: Panza G., Kossobokov V. G., Laor E. & De Vivo B., Eds.). *Elsevier Book*, Chapter 23, 475-490. doi.org/10.1016/B978-0-12-823503-4.00026-9 + 2 referenca).
- MARKU S., PANZA G. & ORMENI R. (2014).** The necessity of an anti-seismic law in Albania based on NDSHA method of risk calculation. XX Congress of the Carpathian Balkan Geological Association Tirana, Albania, 24-26 September, Special Session SS23. *Buletini i Shkencave Gjeologjike*, Special issue, 1/2014, 462-465.
- MELO V., ÇILI P. & GJENERALI V. (1987).** Gjeologjia strukturore-gjeotektonika. *SH.B "Shtypshkronja e Dispensave"*, 3-4.
- ORMENI R. & MARKU S. (2009).** Evidentimi i strukturave karbonatike me perspektivë naftë-gazmbajtëse të zonës Jonike nën mbijetjen e zonës Kruja, në rajonin Veriu i Dumrese-Rovë-Fortuzaj. *Buletini i Shkencave Gjeologjike*, 1/2009, 61-70.
- PAPA A. (2000).** Aventurat e një nocióni: Albanidet. Pozicioni i Albanideve në brezin e rrudhosur Alpin Mesdhetar. Kongresi i VIII Shqiptar i Gjeoshkencave. *Shtypshkronja Marin Barleti*, 92-93.
- SKRAMI J. & ALIAJ SH. (1995A).** Thrusts and backthrusts on Periadriatic Depression (Albania) deduced from exploratory seismics. *Proc. of XV Congress of the Carpatho-Balkan Geol. Assoc.*, 1139-1143.
- SKRAMI J. & ALIAJ SH. (1995B).** Faults and structural unconformities on Periadriatic Depression revealed by exploratory seismics. *Symposium Albpetrol*, 23-26.
- SHKUPI D. (1984).** Fjalor i Gjeologjisë. *SH.B. "8 Nëntori"*, fq. 660.
- VELAJ T. (2012).** Tectonic style and hydrocarbon evaluation of duplex Kruja zone in Albania. Fq. 236-242. Retrieved from <https://hrcak.srce.hr/86219>
- XHOMO A., KODRA A., XHAFA Z. & SHALLO M. (2011).** Gjeologjia e Shqipërisë (Stratigrafia, Magmatizmi, Metamorfizmi, Tektonika, Neotektonika dhe evolucioni paleogeografik e gjeodinamik). *SH.B. "Ngjyrrat e Kohës"*, Tiranë.

VLERËSIMI FILLESTAR I GJEOMORFOSITEVE NË BASHKINË POGRADEEC NËPËRMJET METODOLOGJISË GAM

ERMIONA BRAHOLLI^{1*} & OKSANA KREKA²¹Universiteti Fan S. Noli, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, Bulevardi Rilindasit 11, Korçë, Shqipëri.²Muzeu Mesjetar i Korçës, Bulevardi Fan S. Noli, Korçë, Shqipëri.

*Autor korrespondent: ermiona.braholli@yahoo.com

(Dorëshkrim i dorëzuar në mars 2022; i pranuar për botim në shkurt 2023)

Abstrakt

Gjeomorfositet janë elemente të veçanta të gjeotrashtëgimisë, me vlera të larta shkencore dhe me potenciale të mëdha gjeoturistike. Në këtë studim është përgjeshur të bëhet një vlerësim gjeoturistik i gjashtëmbëdhjetë gjeomorfositeve në Bashkinë Pogradeec. Metodologjia vlerësuese e përdorur është GAM-i (Geomorfosite Assessment Method). Metodologjia GAM synon të evidentojë potencialet gjeoturistike të çdo gjeomorfositi duke paraqitur vlerat shkencore, estetike, të mbrojtjes, funksionale dhe turistike të tyre. Qëllimi kryesor i studimit është të analizojë lidhjen e varësisë ndërmjet nivelit të kërkimit shkencor, bukurive natyrore, nivelit të mbrojtjes dhe vlerave funksionale e turistike të gjeomorfositeve. Në studim bëhet një renditje e gjeomorfositeve sipas vlerave kryesore e plotësuese dhe nxirren në pah përparësitë dhe problematikat që do të ndikojnë në zhvillimin e zonës së studimit për sa i përket aspektit gjeoturistik në të ardhmen.

Fjalë kyçe: Gjeotrashtëgimi, gjeoturizëm, gjeomorfosite, bashkia Pogradeec, metoda GAM.

HYRJE

Në studimet gjeoshkencore po përdoren gjerësisht terma si gjeodiversitet, gjeotrashtëgimi, gjeoresurse, gjeosite, gjeoturizëm etj. Gray (2013) e përkufizon gjeodiversitetin si "objekte apo pamje natyrore gjeologjike, gjeomorfologjike, të tokës dhe të ujërave. Diversiteti gjeologjik përfshin përbërjen, strukturën, sistemet dhe kontributin në peizazh". Pjesë të veçanta të gjeodiversitetit që ndihmojnë në kuptimin e historisë së Tokës (shkëmbinjtje, mineraleve, fosileve dhe peizazheve të saj) emërtohen si trashëgimi gjeologjike ose gjeotrashtëgimi (Adriansyah et al. 2015).

Me fjalë të tjera gjeotrashtëgimia përfshin objekte të natyrës abiotike, të cilat kanë vlera shkencore, krahas vlerave estetike, edukuese, të mbrojtjes, kulturore, ekonomike dhe turistike. Sipas Brihla (2020) elementët abiotikë me vlera shkencore

që ndodhen *in situ* emërtohen gjeosite, ndërsa ato *ex situ* emërtohen site të gjeodiversitetit. Studiuës të ndryshëm (Reynard 2005; Reynard & Panizza 2005; Reynard et al. 2007; Panizza & Piacente 2009), i kanë përkufizuar gjeomorfositet si forma të relievit me atribut të rëndësishëm dhe të veçantë, të cilat i klasifikojnë ato si komponentë të trashëgimisë kulturore të një territori. Në gjeomorfosite përfshihen male, kodra, shpate, shkëmbinjtje të veçantë, shpella, kanione etj., të krijuara nga aktivitetet erozionale apo depozituese të lumenjtjeve, veprimtarive glaciale, valëve detare, proceseve karstike, veprimtarive denuduese apo antropogjene, por që mbartin vlera shkencore, kulturore, historike, estetike, social-ekonomike, për shkak të perceptimit dhe përdorimit human. Ato mund të jenë objekte të thjeshta gjeomorfologjike ose pjesë të mëdha të peizazhit që mund të modifikohen,

dëmtohet, deri edhe të shkatërrohet nga ndikimet e njeriut.

Vlerat e tyre janë pak të njohura për publikun e gjerë, prandaj është i nevojshëm përmirësimi i njohuritë rreth tyre.

Për promovimin e veçorive gjeologjike dhe gjeomorfologjike të peizazhit si atraksion turistik shërben gjeoturizmi, i cili është një lloj turizmi i qëndrueshëm që ka në fokus kryesor veçoritë gjeologjike të Tokës, në mënyrë që të nxisë kuptimin mjedisor dhe kulturor, vlerësimin dhe ruajtjen e saj (Dowling & Newsome 2006; Newsome & Dowling 2010; Newsome et al. 2012; Dowling 2013). Gjeoturizmi i jep mundësi turistit të njohë gjeologjinë lokale, si dhe të kuptojë më mirë që kjo gjeologji është e lidhur ngushtë me të gjitha pasuritë e tjera të territorit, siç janë: biodiversiteti, vlerat arkeologjike dhe kulturore (Martini et al. 2012).

Studimi ynë në këtë artikull përqendrohet tek vlerësimi gjeoturistik i gjeomorfositëve në bashkinë Pogradec. Territori bashkiak i Pogradecit shfaq potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e gjeoturizmit për shkak të një numri të lartë të gjeomorfositëve. Në literaturën shqiptare nuk njeh përdorim termi gjeomorfosit. Studiuesit shqiptarë përdorin gjerësisht termat gjeomonumente dhe hidromonument, terma të huazuar nga IUCN-ja (Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës), në kategorizimet që bën për Zonat e Mbrojtura. Gjeomonumentet janë formacione natyrore (gjeologjike apo gjeomorfologjike), si: forma reliev, mikroforma, depozitime minerale ose një habitat i një lloji të veçantë e i kërcënuar, me rëndësi estetike, ekologjike dhe turistike (KRSH 2002). Në hidromonumente përfshihen burime ujore, lumenj, liqene, ujëvara, laguna, kënetat me rëndësi shkencore, si dhe me vlera edukuese, estetike, turistike etj. Duke qenë se termat gjeo/hidromonumentet dhe gjeomorfositet janë sinonime të njëra-tjetrës, në studim do të përdoret termi

gjeomorfosit, për të qenë më koherent dhe për t'u njësuar me studimet shkencore ndërkombëtare.

NDËRTIMI GJEOLGJIK

Bashkia Pogradec, e përfshirë në këtë studim është, sipas ndarjes më të re administrativo-territoriale e Shqipërisë të vitit 2014 (KRSH 2014), organizohet në 8 njësi administrative (Pogradeci, Hudënishti, Buçimas, Proptisht, Trebinjë, Dardhas, Çerravë, Velçan), me 72 vendbanime rurale dhe 1 vendbanim urban (qyteti i Pogradecit). Hapësira gjeografike në studim njihet për popullimin e hershëm (6000 vjet p.e.s) dhe të vazhdueshëm. Koha e gjatë historike dëshmohej nga elementët e trashëgimisë kulturore si: kala, ura, banesa, varre monumentale dhe objekte kulturi, të cilat janë bërë pjesë e peizazhit të territorit bashkiak. Popullsia ka qenë gjithmonë në rritje dhe sipas Censurit të vitit 2011 numri i popullsisë është 61.713 banorë (INSTAT 2011). Institucioni bashkiak është përgjegjësi kryesor vendor në mbrojtjen, menaxhimin dhe përdorimin e pasurisë natyrore në tërësi dhe gjeotrashëgimisë në veçanti. Në krijimin e gjeomorfositëve ka rëndësi ndërveprimi i tektonikës dhe litologjisë me elementët klimaterikë dhe biodiversitetin.

Në pikëpamjen e ndërtimit gjeologjik, zona e studiuar (Fig. 1) bën pjesë në zonën Mirdita dhe në basenin Albano-Thessalian (Pashko 2018), të cilat karakterizohen nga lëvizje diferencuese të fuqishme neotektonike. Relievi ka dalë mbi ujë gjatë Triasikut dhe Jurasikut dhe kjo vërtetohet nga shkëmbinjtë gëlqerorë të kësaj periudhe (Qiriazhi 2019). Në zonën e studimit janë të pranishëm depozitime të Triasikut (gëlqerorë të Triasikut të poshtëm - të mesëm T_{1-2}), Triasik - Jurasikut, (Triasik i Mesëm - Jurasik i mesëm $T_2 - J_2$, Triasik i Poshtëm - Jurasik i poshtëm $T_3 - J_1$) depozitime të Jurasikut të mesëm (harcburgite dJ_2 dhe formime të shtrijës metamorfike μ_2) Jurasik

– Kretakut (depozitimet terigjeno – ofiolitike të Titionian - Valazhanian $J_3^1 - Cr_4^1$), gëlqerorët e konglomeratët e Kretakut të Poshtëm (Cr_1), gëlqerorët të Kretakut të Sipërm (senomanianit Cr_{sen}), depozitime të Paleogjenit, (ranorë e konglomerate të Eocenit të Mesëm Pg_2^2 dhe Oligocenit të Mesëm Pg_2^3) depozitime të Paleogjen – Neogjenit (argjila e qymyre

të Oligocenit të Sipërm - Akuitanianit ($Pg_3^3 - N_1^1a$), depozitimet Neogjenit (Akuitanianit N_1^1a , Plioceni N_2) si dhe depozitimet e Pleistocen-Holocenit (Q_{p-h}) dhe Holocenit (Q_h) (Xhomo et al. 2002). Në pjesën qendrore të zonës dominojnë depozitimet terigjene, kurse në pjesët periferike shkëmbinjtë kryesisht gëlqerorë.




Figura 1. Pozicioni në hartën gjeologjike (skematike) i gjeomorfositëve në Bashkinë Pogradec (1: 25 000/ ArcGIS 10.1, viti 2021).

Shumëllojshmëria gjeologjike e strukturës sinklinale Librazhd-Mokër (Qiriazzi 1985) në bashkëveprim me klimën mesdhetare paramalore (Kru-taj et al. 1990) kanë mundësuar krijimin e formave të veçanta të relievit lumor, liqenor, eolik, erozivo-denu-dues dhe karstik me rëndësi gjeoshkencore.

Zona e Pogradecit është e pasur burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore si: përrrenj, burime të shumta karstike, (Tushemisht, Drilon, Shën Naum); liqene (liqeni i Ohrit, liqeni i Madh, liqeni i Lukovës, liqenet e Gur Topit); lumenj (rrjedhja kryesore e lumit Shkumbin, lumi i Çërravës, lumi i Drilonit, lumi i Vërdovës, lumi i Pogradecit dhe lumi Tërhanit, etj), si dhe një pjesë e pellgjeve ujëmbledhës të lumit Drin dhe Shkumbin (Pano 2015). Trashëgimia natyrore e Pogradecit përfaqësohet nga: siti i UNESCO-s, Trashëgimia Natyrore e

Kulturore e Rajonit të Ohrit; nga 40 Monumente Natyre (M. N.) (Qiriazzi & Sala 2006); nga Burimi i Menaxhuar i Gurit të Nikës (kategoria IV-t) dhe Peizazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Liqenit të Ohrit (kategoria V-të) (Qiriazzi 2019). Pjesë e trashëgimisë natyrore dhe e gjeotrashëgimisë janë 16 gjeomorfosite (pjesë e M. N.), me rëndësi shkencore gjeologjike/gjeomorfologjike të evidentuara në listën e Monumenteve të Natyrës (KRSN 2019) dhe në listën e gjeomonume-teve të evidentuara nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (Neziraj et. al. 2021). Në bashkinë e Pogradecit gjenden katër objekte natyrore të karakterit hidrogeomorfologjik, shtatë objekte natyrore të karakterit karstik, një objekt të karakterit lumor dhe 6 objekte të karakterit eolitic. Në figurën 1 jepet vendndodhja dhe klasifikimi sipas nivelit të vlerësimit shkencor, ndërsa emërtimi korrespondues i tyre paraqitet në tabelën 1.

Tabela 1. Tipologjia dhe vlerësimi shkencor i gjeomorfositeve të bashkisë Pogradec (Neziraj et. al. 2021).

Nr.	Gjeomorfositet	Tipi	Vlera shkencore
1	Liqeni i Ohrit	Gjeomorfologjike-Litologjike-Tektonike	Ndërkombëtare
2	Liqenet e Lukovës	Gjeomorfologjike-Litologjike-Tektonike	Lokale
3	Gadishulli i Linit	Gjeomorfologjike/Neotektonike	Kombëtare
4	Shpella e Najzmës	Gjeomorfologji/Karstike	Lokale
5	Shpella e Shën Marenës	Gjeomorfologji/Karstike	Lokale
6	Shpella e Baribardhës	Gjeomorfologji/Karstike	Lokale
7	Shpella e Memëlishtit	Gjeomorfologji/Karstike	Lokale
8	Shpella e Ariut, Bishnicë	Gjeomorfologji/Karstike	Lokale
9	Kanioni i Llëngës	Gjeomorfologji/Lumore	Lokale
10	Bashkimi i Shkumbinit me atë të Dushës	Gjeomorfologjik/Lumore	Lokale
11	Guri i Kamjes	Gjeomorfologjike/Atmosferike	Kombëtare
12	Gurët Nusja dhe Dhëndëri	Gjeomorfologjike/Atmosferike	Lokale
13	Mullarët e gurtë Trebinjë	Gjeomorfologjike/Atmosferike	Lokale
14	Piramida e tokës së Qafë Panjës	Gjeomorfologjike/Atmosferike	Lokale
15	Piramida e tokës së Kalivaçit (Koka e Balos)	Gjeomorfologjike/Atmosferike	Lokale
16	Mali i Niçës	Gjeomorfologjike/Atmosferike	Lokale

Përshkrimi i gjeomorfositeve të studiuar

Bazuar në literaturën shkencore dhe në ekspeditat në terren, më poshtë jepen shkurtimisht disa të dhëna rreth gjeomorfositeve në Bashkinë Pogradec (Fig. 2).

Liqeni i Ohrit (*Lacus Luchnidus*) përfaqëson një masë të madhe ujore ndërkufitare, e grumbulluar mbi grabenin e Ohrit në fund të Mioce-nit - fillim të Pliocenit (Pano 2015). Lëvizjet neotektonike shprehëse (grabenore) me intensitet ulës, më të lartë krahasuar me grabenet përreth (i Korçës, Prenjasit etj.), kanë mundësuar formimin e liqenit me sipërfaqe 362.6 km² dhe thellësi maksimale 295 m (Qiriazzi 2019). Ohri konsiderohet një nga liqenet më të mëdhenj në grupin e liqeneve karstike, me veçori floristike e faunistike arkaike (Clarke et al. 2000; Pano 2015). Numri i lartë i specieve endemike dhe relikte në ujërat e ëmbla të liqenit e kanë përfshirë atë në trashëgiminë botërore mikse (Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e rajonit të Ohrit, UNESCO 2019). Njëkohësisht sipërfaqja ujore prej 111.4 km² e territorit Shqiptar është shpallur "Peizazh i Mbrojtur", kategoria e V-të e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri.

Liqenet e Lukovës janë krijuar në cirqe akullnajore në lartësitë 1700 m dhe 1830 m mbi nivelin e detit (Qiriazzi & Sala 2006; Qiriazzi 2020). Liqenet janë të pozicionuar në shpatin lindor të malit Guri i Topit, ku terreni ultrabazik paraqitet me valëzime të vogla, i modeluar nga lëvizjet e akullnajave të dikurshme. Në fundin e liqeneve gjenden morena të mbetura, të cilat pengojnë infiltrimin e ujit në thellësi. Furnizuesi kryesor me ujë i liqeneve është shkërrja e dëborës. Liqenet kanë formë ovale, të rrethuar me pyje ahu dhe bredhi qindravjeçarë. Liqenet janë pjesë e Monumenteve të Natyrës në Shqipëri.

Gadishulli i Linit ndodhet në brigjet perëndimore të liqenit të Ohrit në

lartësinë rreth 90 m mbi pasqyrën e liqenit. Përfaqëson një shkëmb gëlqeror i ndërthurur me shkëmbinj silicorë radiolaritikë të periudhës Triasike (mbi 200 milion vjeçar) me gjatësi 2 km dhe gjerësi 1.5 km (Mazelli et al. 2016). Sipas Qiriazzi (1985) gadishulli, i cili është formuar nga tërheqja e ujërave të liqenit, paraqitet me thepisje tektoniko-abrazive, ku gjenden faleza të gjalla (Qiriazzi 2019). Prej vitit 2019 është pjesë e trashëgimisë botërore si pjesë e "Trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit" (UNESCO, 2019). Gadishulli është dëshmitar i trashëgimisë kulturore, gjë që shprehet në praninë e mozaikut të Linit, kishës së shekullit të VI-të p.e.s dhe disa palafiteve (Menkshi 2020).

Shpella e Najzmës është një formë reliev karstike nëntokësore, e krijuar në shkëmbinj gëlqerorë të T₃-J₁ (Qiriazzi & Sala 2006). Procesi i karstogjenezës vazhdon të zhvillohet intensivisht duke qenë së në të buron me zhurmë një burim karstik. Shpella ndodhet pranë pikës kufitare të Tushemishtit.

Shpella e Shën Marenës është një shpellë karstike, e krijuar nga zhvillimi i karstit nëntokësor në gëlqerorë e Cr₁. Shpella është vendosur në 25 m thellësi, ku janë të dukshëm shkëmbinjtë e karstëzuar e të mbushur me konkrecione (Mazelli et al. 2016). Shpella gjendet në malësinë e Mokrës, njësi administrative Trebinjë, pranë fshatit Llëngë, në lartësinë 1100 m mbi nivelin e detit. Shpella mban emrin e shenjtores Mari.

Shpella e Baribardhës është një shpellë karstike e krijuar nga procesi i karstogjenezës në gëlqerorët e Cr₁. Shpella ka një gjatësi rreth 30 m, gjerësi rreth 3 - 4 m dhe lartësi 2 - 3 m (Qiriazzi & Sala 2006). Mbrohet ligjërisht si kategori e III-të e Zonave të Mbrojtura.

Shpella e Memlishtit ose shpella e ujit ndodhet pranë fshatit Memëlisht, njësi administrative Udenisht. Shpella është formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të kurrizit të Gurit të Kuq, të cilët i përkasin periudhës së Cr₁. Prania e ujit në shpellë shpreh vazhdimësinë e procesit të karstogjenezës në ditët e sotme. Eksploruesit e shpellës dëshmojnë se gjatësia e saj është rreth 300 - 400 m, gjerësia rreth 10 m dhe lartësia deri në 25 m.

Shpella e Ariut (Bishnicë) është një shpellë karstike në shpatin lindor të Gurit të Topit. Shpella zhvillohet në drejtim vertikal në thellësi rreth 60 m, ku sipas eksploruesve përbëhet nga 3 salla që lidhen me njëra-tjetrën me korridore. Në shpellë gjenden stalaktide dhe stalagmide të pa dëmtuara. Në të është gjetur skeleti i një ariu, e cila është arsyeja pse mban emrin

shpella e Ariut. Shpella ndodhet në lartësinë 1150 m mbi nivelin e detit, afër fshatit Bishnicë.

Kanioni i Llëngës ose Gryka e Gurit është formuar prej ujërave të përroit të Gurrës (degë e djathtë e Shkumbinit), i cili mbivendoset dhe pret tërthor vargun gëlqeror Shkëmbi i Llëngës-Maja e Gurit. Veprimtaria gërryese lumore dhe zhvillimi i karstogjenezës gjatë lëvizjeve tektonike ngritëse kanë krijuar një kanion me lartësi rreth 60m, gjerësi rreth 15m dhe gjatësi 1 km (Qiriazzi & Sala 2006). Në kanion gjenden gjurmë të kalldrëmit të rrugës Egnatia (shek. II-të p.e.s) që lidhte malësinë e Mokrës me malësinë e Gorës dhe Voskopojës (Braholli & Menkshi 2020). Kanioni gjendet në fshatin Llëngë, njësi administrative Trebinjë.



Figura 2. Imazhe të gjashtë gjeomorfositeve të bashkisë Pogradec (Burimi i fotove: Braholli E.dhe Kreka O., viti 2020).

Bashkimi i Shkumbinit me atë të Dushës përfaqëson një grykë të ngushtë të formuar në molasa të epokës së Oligocenit (rreth 33.9 milion vjeçare; Mazelli et al. 2016). Molasat janë të llojit argjilo-alevrolito-ranore të çimentuara mire, çka tregojnë qëndrueshmëri ndaj veprimtarisë gërryese të rrjedhjes lumore. Gjeomorfositi nuk gëzon mbrojtje ligjore pavarësisht vlerave shkencore dhe edukuese.

Guri i Kamjes ndodhet pranë fshatit Dardhë, në njësinë administrative Dardhas. Sipas (Avxhi et al. 2015; Miçi & Pazari 2021) guri ka gjatësi 100 m, gjerësi 80 m dhe lartësi 70 m. Forma e tij lidhet me rezistencën më të madhe të konglomeratëve që e përbëjnë në krahasim me argjilat që ndërtojnë territorin përreth tij. Ai ngrihet mbi territoret përreth Kamjes duke marrë pamjen e një vapori.

Gurët "Nusja dhe Dhëndri" ndodhen në afërsi të fshatit Senisht, të njësisë administrative Mokër. Përfaqësojnë dy gurë 3 m të lartë, me përbërje gëlqerore, dhe fortësi jo të njëjtë, të modeluar nga karsti, erozioni dhe era, në formën e "nuses" dhe të "dhëndrit" (Menkshi 2020).

Mullarët e Gurtë – Trebinjë ndodhen afër fshatit Trebinjë, njësi administrative Trebinjë. Gurët gjenden në lartësinë 1150 m mbi nivelin e detit, në kurrizin malor të Dushnës. Mullarët janë një grup gurësh ranorë dhe konglomerat me qëndrueshmëri të ndryshme erozionale, të formuar nga veprimtaria gërryese e erës, me lartësi 3 – 10 m (Braholli & Menkshi 2020). Gurët kanë vlera shkencore kombëtare.

Piramidat e tokës së Qafë Panjës janë gurë konglomeratikë të çimentuar me ranoro-silicorë, në lartësinë 1.489 m mbi nivelin e detit. Piramidat janë mbetje të veprimtarisë erozionale të erës, e cila ka larguar materialin argjilor e ranor, i cili dallohet për vlera të larta të erodimit. Gurët e Akuitanianit i ngajnë një piramide

me lartësi 8 m, gjerësi 2 m dhe gjatësi 3 m (Mazelli et al. 2016). Gurët nuk mbrohen ligjërisht dhe rrezikojnë të erodohen në bazën e tyre.

Piramida e Tokës së Kalivaçit (Koka e Balos) është një gur i ngjashëm në përbërje dhe në moshe me gurët e Qafë Panjës. Janë formuar në lartësinë 1180 m mbi nivelin e detit. Piramida e Tokës së Kalivaçit ka lartësi 4 m dhe i ngjan një kapeleje të gurtë, të vendosur në krye e të modeluar nga era. Ka vlera lokale shkencore dhe nuk mbrohet ligjërisht.

Mali i Niçës ndodhet në njësinë administrative Trebinjë. Mali është pjesë e njësisë fiziko-gjeografike të Malësisë së Mokrës, sektori i Çezmës. Maja më e lartë e malit të Niçës arrin 1687 m mbi nivelin e detit. Aty dallohen shumë forma e mbetje erozionale me veçori e bukuri natyrore të rralla.

METODOLOGJIA

Në vlerësimin gjeoturistik të gjeomorfositeve të Bashkisë Pogradec është përzgjedhur të përdoret metoda GAM (Geosite Assessment Method ose Metoda e Vlerësimit të Gjeomorfositeve), e krijuar nga Vujičić et al. (2011) dhe e aplikuar me efikasitet në mbrojtjen, menaxhimin, konservimin dhe promovimin e gjeomorfositeve në vende të ndryshme të Evropës. Nëpërmjet GAM-it synohet të përcaktohet niveli i vlerave shkencore, edukuese, estetike, të mbrojtjes, funksionale dhe turistike të gjeomorfositeve, duke analizuar njëkohësisht kushtet e mbrojtjes, konservimit dhe dëmtimit për secilin prej tyre.

Metodologjia GAM përbëhet prej dy grupe vlerash (kryesore dhe plotësuese), ku vlerat kryesore përfshijnë tre nëngrupe (indikatore): a) vlerat shkencore (edukuese); b) vlerat skenike (estetike); c) vlerat e mbrojtjes. Vlerat plotësuese përfshijnë dy nëngrupe (indikatore): a) vlerat funksionale, dhe b) vlerat turistike (Vujičić et

al. 2011).

Vlerat shkencore dhe edukuese (VShE) janë cilësitë bazë, për tu klasifikuar një element abiotik gjeotrashtëgimie dhe përbëhen nga katër nënindikatorë. Vlerat skenike dhe estetike (VSE), po me katër nënindikatorë, janë përfshirë në vlerat kryesore, pasi nuk ndryshojnë në kohë. Vlera e mbrojtjes (VMb) me katër nënindikatorë, shihet si një vlerë kryesore, pasi është një veprimtari e rëndësishme përpara promovimit dhe zhvillimit të turizmit në tërësi. Në total, vlerat kryesore përbëhen nga 12 nënindikatorë.

Vlerat plotësuese (VP) ndahen në dy nëngrupe (indikatorë), vlerat funksionale dhe turistike. Vlerat funksionale (VFn) përbëhen nga gjashtë nënindikatorë, ndërsa vlerat turistike (VT) vlerësojnë gjendjen aktuale të shërbimeve turistike dhe përbëhen nga nëntë nënindikatorë. Këto nuk janë elementë të drejtpërdrejtë të turizmit, por që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e gjeoturizmit. Në total GAM-i përbëhet nga 12 nënindikatorë të vlerave kryesore dhe 15 nënindikatorë të vlerave plotësues, të paraqitura dhe të shpjguara në tabelën 2. Për çdo nënindikator do të ketë një mundësi vlerësimi numerik, që fillon nga vlera më e vogël e deri tek vlera më e lartë: 0.00, 0.25, 0.50, 0.75 dhe 1.00. Vlerësimet numerike paraqiten në tabelën 3. Për të përcaktuar vlerat kryesore të gjeomorfositeve kryhet shumatorja e vlerave shkencore/ edukuese me vlerat estetike/etike dhe vlerat e mbrojtjes. Formula paraqitet si më poshtë:

$$VK = VShE + VSE + VMb = \sum_{i=1}^{12} SIVM_i \text{ ku: } 0 \leq SIVM_i \leq 1$$

Vlerat plotësuese përcaktohen nga shumatorja e vlerave funksionale dhe e vlerave turistike. Formula e mëposhtme shpreh vlerësimin plotësues:

$$VP = VFn + VT = \sum_{j=1}^{15} SIVAJ_j \text{ ku: } 0 \leq SIVAJ_j \leq 1$$

Këtu, $SIVM_i$ dhe $SIVAJ_j$ përfaqësojnë 12 nënindikatorët ($i = 1, \dots, 12$) për

vlerat kryesore dhe 15 nënindikatorët ($j = 1, \dots, 15$) për vlerat plotësuese për çdo gjeomorfosit (Tab. 2).

Të dhënat matematikore, të përfituara, do të vendosen në një grafik të përbërë nga boshti i X-ve (boshti horizontal) dhe boshti i Y-ve (boshti vertikal). Në boshtin e X-ve janë vendosur 12 vlerat kryesore dhe në boshtin e Y-ve janë vendosur 15 vlerat plotësuese.

Grafiku është i ndarë në 9 zona, ku secili prej tyre përbëhet nga 4 vlera kryesore dhe 5 vlera plotësuese. Zonat marrin emërtimet $Z_{11}, Z_{21}, \dots, Z_{33}$ dhe duke kaluar nga zona Z_{11} në zonën Z_{33} për gjeomorfositet rriten vlerat kryesore dhe plotësuese.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Përdorimi i metodologjisë GAM kërkonte një punë të vazhdueshme në grumbullimin e informacioneve gjeoshkencore; vëzhgimin dhe analizat e hartave topografike 1:25 000, eksplorimi i terrenit me Google Earth; vizitat në terren dhe konsultat me menaxhuesit lokal të gjeotrashtëgimisë. Gjatë ekspeditave në terren u anketuan banorë vendas, turistë të rastësishëm, udhërrëfyes turistike, të cilët ndihmuan në vlerësimin cilësor të nënindikatorëve për gjashtëmbëdhjetë gjeomorfositet. Vlerësimet objektive të përfituara janë shndërruar nga studiuesit në vlera numerike, vlerësim nga 0.00 në 1.00 për çdo nënindikator, siç tregohen në tabelat e mëposhtme 2 dhe 3. Në tabelën 4 janë përlogaritur shumatorët e vlerat kryesore dhe vlerat plotësuese, duke përcaktuar njëkohësisht zonën ku pozicionohen gjeomorfositet.

Tabela 2. Vlerësimet të gjeomorfositeve në Bashkinë Pogradec (GS 1 – GS 8).

Indikatorët/ Subindikatorët	Vlerat e dhëna nga ekspertët (0.00-1.00)							
	Liqeni i Ohrit GS 1	Liqenet e Lukovës GS 2	Gadishulli i Linit GS 3	Shpella e Na- jzmes GS 4	Shpella e hën Marenës GS 5	Shpella e Bari- bardhës GS 6	Shpella e Mem-lishtit GS 7	Shpella e Arit GS 8
Vlerat kryesore (VK)								
I. Vlerat shkencore/ edukuese (VShE)								
1. Sa e rrallë ($SIVK_1$)	1.00	0.25	0.50	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2. Përfaqësueshmëria ($SIVK_2$)	0.75	0.50	0.75	0.25	0.50	0.50	0.25	0.00
3. Njohuritë në fushën e gjeoshkencës ($SIVK_3$)	1.00	0.50	0.75	0.25	0.50	0.25	0.50	0.25
4. Niveli i interpretimit ($SIVK_4$)	1.00	1.00	0.50	0.50	0.75	0.75	0.75	0.50
II. Vlerat skenike/ estetike (VSE)								
1. Pikëpamjet ($SIVK_5$)	1.00	0.50	1.00	0.25	0.00	0.50	0.25	0.25
2. Sipërfaqja ($SIVK_6$)	1.00	0.50	0.50	0.00	0.00	0.50	0.00	0.50
3. Natyra e peizazhit përreth ($SIVK_7$)	0.75	0.75	0.75	0.50	0.50	0.25	0.75	0.50
4. Përshtatshmëria me mjedisin ($SIVK_8$)	1.00	1.00	1.00	0.50	0.50	0.50	0.50	1.00
III. Mbrojtja (VM)								
1. Statusi i mbrojtjes ($SIVK_9$)	0.75	0.75	0.50	0.75	0.50	0.25	1.00	1.00
2. Niveli i mbrojtjes ($SIVK_{10}$)	1.00	0.75	1.00	0.50	0.75	0.25	0.75	0.00
3. Dobësitë ($SIVK_{11}$)	0.75	0.75	0.75	0.75	0.75	0.50	0.75	1.00
4. Nr. i vizitorëve të lejueshëm ($SIVK_{12}$)	1.00	1.00	0.50	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25
Vlerat plotësuese (VP)								
I. Vlerat funksionale (VF)								
1. Arritshmëria ($SIVF_1$)	1.00	1.00	0.50	0.25	0.25	0.75	0.25	0.25
2. Vlerat natyrore plotësuese ($SIVF_2$)	0.75	0.50	0.25	0.50	0.50	0.00	0.50	0.25
3. Vlerat kulturore plotësuese ($SIVF_3$)	1.00	0.50	0.50	0.50	0.75	0.00	0.25	0.25
4. Afërsia e qendrës rrezatuese ($SIVF_4$)	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
5. Afërsia me rrugët më të rëndësishme ($SIVF_5$)	1.00	1.00	1.00	1.00	0.25	0.25	1.00	0.25
6. Vlerat funksionale plotësuese ($SIVF_6$)	0.50	0.75	0.50	0.25	0.00	0.25	0.50	0.00
II. Vlerat turistike (VT)								
1. Promovimi ($SIVT_1$)	1.00	0.75	1.00	0.00	0.50	0.25	0.00	0.00
2. Vizitat e organizuara ($SIVT_2$)	1.00	1.00	0.25	0.25	0.50	0.50	0.00	0.25
3. Afërsia e qendrës së vizitorëve ($SIVT_3$)	0.75	0.50	0.50	0.50	0.00	0.25	0.75	0.00
4. Panelet interpretuese ($SIVT_{10}$)	0.50	0.50	0.00	0.00	0.25	0.00	0.00	0.00
5. Numri i vizitorëve vjetor ($SIVT_{11}$)	0.75	0.75	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25
6. Infrastruktura turistike ($SIVT_{12}$)	0.75	0.50	0.25	0.00	0.00	0.25	0.00	0.00
7. Shërbimet e guidave turistike ($SIVT_{13}$)	0.25	0.50	0.25	0.00	0.25	0.25	0.00	0.25
8. Shërbimet e hotelarisë ($SIVT_{14}$)	1.00	1.00	1.00	1.00	0.25	0.25	1.00	0.00
9. Shërbimet e restoranteve ($SIVT_{15}$)	1.00	1.00	1.00	0.75	0.00	0.00	0.75	0.00

Tabela 3. Vlerësime të gjeomorfositëve në Bashkinë Pogradec (GS 9 – GS 16).

Indikatorët/ Subindikatorët	Vlerat e dhëna nga ekspertët (0.00-1.00)							
	Kanoni i Lëngës GS 9	Bashkimi i Shkumbinit – Dushës GS 10	Guri i Kamjes GS 11	Gurët "Nusia dhe Dhëndri" GS 12	Mullarët e gurtës Trebinië GS 13	Piramida e tokës së Qafë Panjës GS 14	Piramida e Tokës së Kalivaçit (Koka e Balos) GS15	Mali Niçë GS 16
Vlerat kryesore (VK)								
I. Vlerat shkencore/ edukuese (VShE)								
1. Sa e rrallë ($SIVK_1$)	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25
2. Përfaqësueshmëria ($SIVK_2$)	0.50	0.75	0.75	0.75	0.50	0.25	0.25	0.50
3. Njohuritë në fushën e gjeoshkencës ($SIVK_3$)	0.50	0.50	0.75	0.25	0.50	0.25	0.25	0.25
4. Niveli i interpretimit ($SIVK_4$)	1.00	0.50	0.50	0.75	0.75	0.50	0.50	0.50
II. Vlerat skenike/ estetike (VSE)								
1. Pikëpamjet ($SIVK_5$)	0.25	0.50	1.00	0.50	1.00	0.50	0.50	0.50
2. Sipërfaqja ($SIVK_6$)	1.00	0.00	0.50	0.00	0.00	0.00	0.00	0.50
3. Natyra e peizazhit përreth ($SIVK_7$)	0.75	0.25	0.75	0.50	0.50	0.50	0.50	0.75
4. Përshtatshmëria me mjedisin ($SIVK_8$)	1.00	1.00	1.00	0.50	0.50	0.50	0.50	1.00
III. Mbrojtja (VM)								
1. Statusi i mbrojtës ($SIVK_9$)	0.25	0.50	0.75	0.25	0.25	0.75	0.75	0.75
2. Niveli i mbrojtjes ($SIVK_{10}$)	0.75	0.25	0.75	0.25	0.75	0.50	0.50	0.25
3. Dobësitë ($SIVK_{11}$)	0.50	0.50	0.50	0.50	0.00	0.50	0.50	0.50
4. Nr. i vizitorëve të lejueshëm ($SIVK_{12}$)	0.75	0.25	0.50	0.50	1.00	0.25	0.25	0.25
Vlerat plotësuese (VP)								
I. Vlerat funksionale (VF)								
1. Arritshmëria ($SIVF_1$)	0.75	0.50	0.25	0.50	0.75	0.25	0.25	0.25
2. Vlerat natyrore plotësuese ($SIVP_2$)	0.75	0.50	0.25	0.00	0.00	0.50	0.25	0.25
3. Vlerat kulturore plotësuese ($SIVP_3$)	0.75	0.75	0.25	0.25	0.50	0.00	0.00	0.75
4. Afërsia e qendrës rrezatuese ($SIVP_4$)	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
5. Afërsia me rrugët më të rëndësishme ($SIVP_5$)	0.25	0.25	0.25	0.25	1.00	0.25	0.25	0.25
6. Vlerat funksionale plotësuese ($SIVP_6$)	0.00	0.25	0.00	0.25	0.00	0.00	0.25	0.00
II. Vlerat turistike (VT)								
1. Promovimi ($SIVP_7$)	0.50	0.00	0.75	0.25	0.00	0.00	0.00	0.00
2. Vizitat e organizuara ($SIVP_8$)	0.50	0.00	0.50	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25
3. Afërsia e qendrës së vizitorëve ($SIVP_9$)	0.00	0.25	0.25	0.25	0.00	0.25	0.25	0.25
4. Panelet interpretuese ($SIVP_{10}$)	0.25	0.00	0.25	0.00	0.25	0.00	0.25	0.00
5. Numri i vizitorëve vjetor ($SIVP_{11}$)	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25
6. Infrastruktura turistike ($SIVP_{12}$)	0.00	0.25	0.25	0.25	0.00	0.25	0.25	0.25
7. Shërbimet e guidave turistike ($SIVP_{13}$)	0.25	0.00	0.50	0.25	0.25	0.00	0.00	0.25
8. Shërbimet e hotelierisë ($SIVP_{14}$)	0.25	0.50	0.50	0.25	0.50	0.25	0.25	0.25
9. Shërbimet e restoranteve ($SIVP_{15}$)	0.00	0.25	0.25	0.00	0.25	0.00	0.00	0.00

Në grupin e gjeomorfositëve të bashkisë Pogradec, vlerat më të larta kryesore dhe plotësuese i ka Liqeni i Ohrit (GS 1). Sipas figurës 3, Ohri pozicionohet në Z_{33} sepse ka vlera të larta shkencore, edukuese, estetike dhe mbrojtëse. Liqeni ndodhet pranë rrugëve kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare, pranë zonave të banuara dhe përdoret gjerësisht për zhvillimin e turizmit banlear, peshkimit etj.

Gjeomorfositet e zonës Z_{22} , si: Gadishulli i Linit (GS 3), Shpella e Najazmës (GS 4) dhe shpella e Memëlishtit (GS 7) karakterizohen nga vlerat mesatare kryesore dhe plotësuese gjeoturistike. Mbrojtja në nivel kombëtar prej legjislacionit shqiptar, vlerat e larta edukuese për brezat e rinj

nëpërmjet informacioneve gjeoshkencore, si dhe bukuria natyrore bën që të tri gjeomorfositet të vlerësohen me vlera mesatare kryesore. Distanca e afërt me objektet të tjera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, afërsia me qendrën e vizitorëve dhe rrugëve nacionale. si dhe numri i lartë i shërbimeve të hotelierisë e restoranteve bën që Gadishulli i Linit, Shpella e Najazmës dhe shpella e Memëlishtit të kenë vlera mesatare plotësuese. Për të rritur vlerat kryesore gjeoturistike të të tri gjeomorfositëve është i rëndësishëm thellimi i kërkimit shkencor në të ardhmen; përfshirja e tyre në guida gjeoturistike, e cila kërkon infrastrukturë gjeoturistike, drejtues turistikë (ciceronë) të specializuar në gjeoshkencë.

Tabela 4. Zonimi i gjeomorfositëve në bazë të modelit GAM.

Gjeomorfositet (Shërbimit Gjeologjik Shqiptar)	Vlerat kryesore (VShE+ VSE+ VM)	Vlerat funksionale (AV=Vfn+Vtr)	Zona
Liqeni i Ohrit (GS 1)	3.75+3.75+3.25=10.75	4.25+7.00= 11.25	Z_{33}
Liqenet e Lukovës (GS 2)	2+1.75+2.75=6.50	1.00+0.75= 1.75	Z_{21}
Gadishulli i Linit (GS 3)	2.50+2.25+2.75=7.50	2.75+4.50= 7.25	Z_{22}
Shpella e Najazmës (GS 4)	1.00+1.25+2.50=4.75	2.50+2.75= 5.25	Z_{22}
Shpella e Shën Marenës (GS 5)	1.75+1+2.25=5	1.75+2=3.75	Z_{21}
Shpella e Baribardhës (GS 6)	1.5+1.75+1.25=4.5	1.25+2= 3.25	Z_{21}
Shpella e Memëlishtit (GS 7)	1.50+1.50+2.25=5.75	2.50+2.75=5.25	Z_{22}
Shpella e Ariut, Bishnicë (GS 8)	0.75+2.25+2.25=5.25	1.00+0.75=1.75	Z_{21}
Kanioni i Lëngës (GS 9)	1.75+3+2.25=7	2.50+2.00=4.50	Z_{21}
Bashkimi i Shkumbinit me atë të Dushës (GS 10)	2+1.75+1.5=5.25	2.25+1.5= 3.75	Z_{21}
Guri i Kamjes (GS 11)	2.25+3.75+2.50=8	1+3.50= 4.50	Z_{21}
Gurët Nusia dhe Dhëndri (GS 12)	2+1.5+1.5=5	1.25+1.75= 3	Z_{21}
Mullarët e gurtës Trebinjë (GS 13)	2+2+2=6	2.25+1.75=4	Z_{21}
Piramida e tokës së Qafë Panjës (GS 14)	1.25+1.50+2=5.75	1+1.25=2.25	Z_{21}
Piramida e tokës së Kalivaçit (Koka e Balos) (GS 15)	1.25+1.50+2=5.75	1+1.25= 2.25	Z_{21}
Mali i Niçës (GS 16)	1.5+2.75+1.75=6	1.5+1.5= 3	Z_{21}

Liqenet e Lukovës (GS 2), Shpella e Shën Marenës (GS 5), e Baribardhës (GS 6), e Ariut (GS 8), Kanioni i Llëngës (GS 9), Bashkimi i Shkumbinit me atë të Dushës (GS 10), Guri i Kamjes (GS 11), Gurët Nusja dhe Dhëndri (GS 12), Mullarët e Gurtë të Trebinjës (GS

13), Piramida e tokës së Qafë Panjës (GS 14), Piramida e tokës së Kalivaçit (GS 15) dhe Mali i Niçës (GS 16) bëjnë pjesë në zonën Z21. Gjeomorfositet kanë vlera mesatare kryesore dhe vlera të ulëta plotësuese.




Figura 3. Pozicioni i gjeomorfositeve në grafikun e GAM-it.

Edhe pse jo të gjithë gjeomorfositet mbrohen në nivel kombëtar, vlerat estetike të tyre, madhësia dhe potenciali gjeoedukues i tyre është i lartë. Vlerat e ulëta plotësuese përcaktohen nga largësia fizike dhe kohore nga qendrat kryesore urbane, infrastruktura rrugore dhe turistike e ulët, niveli i ulët i turistëve (turistë aventurë), si dhe mungesa e shërbimeve të restoranteve dhe hotelierisë pranë tyre. Dëmtimi natyror dhe human si: ndërimi i hidrocentraleve në Llëngë, gjurmimet në gjeomorfosite, dëmtimi i Mullarëve të Gurtë të Trebinjës nga ndërtimi i rrugës automobilistike Qukës-Qafë Pllocë, përdorimi i ujit të liqenit të Lukovës për ujti etj., do të sjellë dëmtimin e parikthyeshem të gjeomorfositeve dhe humbja e plotë e vlerave gjeoturistike.

PËRFUNDIME

Vlerësimet e trashëgimisë natyrore janë të rëndësishme në zhvillimet

e sotme urbane dhe në kërkesat e larta për lëvizje turistike. Gjeoturizmi është formë e re e lëvizjes turistike me mundësi të mëdha zgjerimi në vendin tonë. Vetëm Bashkia e Pogradecit mbart potenciale të larta gjeoturistike. Pavarësisht se gjeomorfositet paraqiten përgjithësisht me përmasa të vogla, unikaliteti i tyre i bën tepër edukues, tërheqës dhe turistike. Duke qenë se objektet e gjeodiversiteti perceptohen si të pandryshueshme dhe të pakërcënueshëm në nivelin institucionale dhe e popullsisë lokale është tepër i ulët. Financimet në kuadër të mbrojtjes, promovimit dhe konservimit të gjeotrashëgimisë janë tepër të ulëta. Në gjeomorfosite janë evidentuar ndërhyrje institucionale me nivele të larta dëmtimi, deri në humbjen totale të gjeomorfositit. Mbrojtja, ruajtja dhe konservimi i gjeomorfositeve kërkon thellimin e kërkimit shkencor në Bashkinë Pogradec dhe edukimin e komunitetit lokal,

turistëve dhe menaxherëve turistikë. Duhet të kuptohet që gjeodiversiteti është elementi bazë mbi të cilën zhvillohet biodiversiteti dhe diversiteti kulturor. Gjeomorfositet duhet të in-

tegrohen në politikat dhe programet lokale e kombëtare, duke mundësuar konservimin e tyre dhe zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor, kulturor dhe ekonomik.

REFERENCAT

- AVXHI A., AHMETAJ A. & MISHA V. (2015). *Gjeologjia-Gjeoresurset dhe Gjeorreziket dhe Mjedisi në Bashkitë e Shqipërisë*. Tiranë: Bashkia Pogradec.
- ADRIANSYAH D., BUSU I., EVA H. & MUQTADA M. (2015). Geoheritage as the basis for geotourism development: A case study in Jeli District, Kelantan, Malaysia. *Geojournal of Tourism and Geosites, Romania*, Year VIII, No. 1, Vol. 15, 25-43. ISSN:205-0817.
- BRAHOLLI E. & MENKSHI E. (2020). Geotouristic Potential in Mokra's Maintain Area. *International Multidisciplinary Geosciences Conference IMGC2020*, 8-9 October, Mitrovica, Kosovo, 55-63, ISBN:978-9951-8991-5-4.
- BRIHLA J. (2020). Geoparks and Geological Heritage as promoters of sustainable development. *Actes de la Session Plénière Solennelle, Académie Hassan II des Sciences et Techniques*. Rabat, Maroc, 141-146.
- CLARKE R., KOLEMISEVSKA-GUGULOVSKA T. D., DIMIROVSKI G., GJUKNURI L., GRUPCE L. & ANDREESKI C. (2000). Conservation and conflict resolution in Transboundary Protected Areas: Prespa as an European case-study. *SWIIS 2000*, No. 33, Vol. 8, 127-134. DOI: 10.101/S1474-6670(17)35432-0.
- DOWLING R. K. (2013). Global geotourism - An emerging form of sustainable tourism. *Czech Journal of Tourism*, No. 2, Vol. 2, 59-79 (Czech). DOI: 10.2478/cjot-2013-0004.
- DOWLING R. K. & NEWSOME D. (2006). Geotourism's issues and challenges. In: *Geotourism: Sustainability, Impacts and Managements* (Newsome D., Ed.), Oxford. Elsevier, 242-254. DOI: 10.1016/B978-0-7506-6215-4.50021-X.
- GRAY M. (2013). *Geodiversity: Valuing and conserving abiotic nature*. Wiley-Blackwell, Chichester, 2nd Edition, 1-512. ISBN:978-0-470-74215-0.
- INSTAT (INSTITUTI I STATISTIKAVE) (2011). Population and Housing Census. Korçë, 1-106. http://www.instat.gov.al/media/3065/7_korce.pdf
- KËSHILLI I MINISTRAVE (2019). Vendimi Nr. 303, datë 10.05.2019, PËR MIRATIMIN E LISTËS SË RISHIKUAR, TË PËRDITËSUAR, TË MONUMENTEVE TË NATYRËS SHQIPTARE, Tiranë. *Fletore Zyrtare*, Nr. 68, 68. <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-303-2019-per-monumentet-e-natyres-shqiptare.pdf>
- KRUTAJ F., GRUDA GJ., KABO M., MEÇAJ N., QIRIAZI P., SALA S., ZIU T., KRISTO V. & TROJANI V. (1991). *Gjeografia Fizike e Shqipërisë. Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Qendra e Studimeve Gjeografike*, Tiranë, Albania, Vol. I, 1-400.
- KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (KRSH) (2002). Për Zonat e Mbrojtura. Ligji Nr. 8906, datë 06.06.2002. <https://planifikimi.gov.al/index.php?elD=dumpFile&t=f&f=2367&token=54bbf5d912fae53bfe3c7bd27b068d58478ac01e>
- KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (2014). Ligji nr. 115/2014 Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë. *Fletore Zyrtare*, Tiranë, 1-26. https://aam.org.al/wp-content/uploads/2018/11/Ligji_115-2014_31.07.2014.pdf
- MARTINI G., ALCALÁ L., BRIHLA J., LANTRIA L., SA A. & TOURTELLOTT J. (2012). Reflections about the geotourism concept. *11th European Geoparks Conference*, Portugal, Arouca Geopark, 1-353.
- MAZELLI D., KAZA N., DORRE P., FERO XH., KOÇI B., KOLA A., BESHKU H., GELAJ A., BELE M., LAMAJ M., HAKLAJ I., DAPI DH., NEZIRAJ A., MOISIU L., AVXHI A., (2016). *Gjeologjia - Gjeoresurset - Gjeorreziket dhe Mjedisi*, shkalla 1:50,000. Bashkia Pogradec. AQTGJ.
- MENKSHI E. (2020). *Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Qarkut Korçë (Vlerat dhe Përdorimi turistik)*. Studim Monografik, Korçë. *Promo Print*, ISBN: 978-9928-146-67-0.
- MICI A. & PAZARI F. (2021). Geosite valorization of Ohrid-Prespa Transboundary Biosphere Reserve. *X International Online ProGEO Symposium*. Segovia: Instituto Geológico y Minero de España. Abstract Book, 9-10. ISBN: 978-84-91-38-112-9.
- NEWSOME D. & DOWLING R. K. (Eds.) (2010). *Geotourism: The tourism of Geology and Land-*

scape. Oxford: Goodfellow Publishers Ltd.

NEWSOME D., DOWLING R. & ANDY Y.F. LEUNG. (2012). The nature and management of geotourism. A case study of two established iconic geotourism destinations. *Tourism Management Perspectives*, Vol. 3, 19-27. DOI: 10.1016/j.tmp.2011.12.009.

PANIZZA M. & PIACENTE S. (2009). Cultural geomorphology and geodiversity. In: *Geomorphosites* (C. A. Reynard, Ed.). Verlag Dr. Friedrich Pfeil. Mynich, 35-48.

PANO N. (2015). Pasuritë ujore të Shqipërisë: Monografi. *Akademia e Shkencave e Shqipërisë*, Tiranë, 1-481. ISBN: 978-99956-13-23-4.

PASHKO P. (2018). Morava Mt. Oligocene-Middle Miocene succession of Albanian-Thessalian Basin, Albania. *Bulletin of the Geological Society of Greece*, No. 1, Vol. 52, 1-46. DOI: <http://dx.doi.org/10.1281/bgs.15837>.

QIRIAZI P. (1985). Morfologjia dhe morfogjeneza e gropave juglindore dhe e maleve përreth tyre. *Universiteti i Tiranës "Enver Hoxha"* Tiranë, 1-202.

QIRIAZI P. (2019). Gjeografia fizike e Shqipërisë. Tiranë. *Mediaprint*, 1-580.

QIRIAZI P. (2020). Trashëgimia natyrore e Shqipërisë (Vlerat, rreziqet dhe menaxhimi). *Akademia e Shkencave e Shqipërisë*, Tiranë, 1-390. ISBN: 978-9928-237-20-0.

QIRIAZI P. & SALA S. (2006). Monumentet e natyrës të Shqipërisë. Botim Elektronik. *Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave*, Tiranë, 1-84.

REYNARD E. (2005). Geomorphological sites, public policies and property right. Conceptualization and examples for Switzerland. *Italian Journal of Quaternary Science*, No. 18, Vol. 1, 323-332.

REYNARD E., FONTANA G., KOZIK L. & SCAPOZZA C. (2007). A method for assessing "scientific" and "additional values" of geomorphosites. *Geographica helvetica*, No. 62, Vol. 3, 148-158. DOI: 10.5194/gh-2-148-2007.

REYNARD E. & PANIZZA M. (2005). Geomorphosites: definition, assessment and mapping. An introduction. *Geomorphologie: relief, processus, environnement*, No. 3, 177-180.

NEZIRAJ A., MOISIU L., AHMETAJ A., VUKZAJ N., SYLARI V., HALILI R., VJERDHA T., LEKAJ GJ (2021). Teksti përmbledhës i Hartës së Gjeomonumenteve të Shqipërisë. *Shërbimi Gjeologjik Shqiptar*, Arkivi Qendror Teknik i Gjeologjisë.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH). <http://www.gsa.gov.al/ZbuloGjeologjine/monumentet.html>

VUJIČIĆ M. D., VASILEVIĆ D. A., MARKOVIĆ S. B., HOSE T. A., LUKIĆ T., HADŽIĆ O. & JANIĆEVIĆ S. (2011). Preliminary Geosite Assessment Model (GAM) and its application of Fruska Gora Mountain, Potencial Geotourism destination of Serbia. *Acta Geographica Slovenica*, No. 51, Vol. 2, 361-377. DOI: 10.3986/AGS1303.

UNESCO (2019). *World Heritage List*. Retrieved 2019, from UNESCO: <https://whc.unesco.org/en/decisions/7366>

XHOMO A., KODRA A., XHAFA Z. & SHALLO M. (2002). Gjeologjia e Shqipërisë (Tekst shpjegues i Hartës Gjeologjike 1:200 000 të vitit 2002). *Botim Elektronik*. Tiranë. p. 1-475.

PRELIMINARY ASSESSMENT OF THE GEOMORPHOSITES FROM THE POGRADEC MUNICIPALITY USING THE GAM METHODOLOGY

ERMIONA BRAHOLLI^{1*} & OKSANA KREKA²

¹Fan S. Noli University, Faculty of Education and Philology, Rilindasit Blvd. 11, Korçë, Albania.

²National Museum of Medieval Art, Fan S. Noli Blvd., Korçë, Albania.

*Corresponding author: ermiona.braholli@yahoo.com

(Manuscript submitted in March 2022; accepted for publication in February 2023)

ABSTRACT

The geomorphosites represent geoheritage sites and landforms assemblages, with high scientific, educational value, and increased geotouristic potential. The goal of this study is the preliminary assessment through GAM methodology (Geomorphosite Assessment Method), of 16 selected geomorphosites located on the Pogradec Municipality's territory. The GAM methodology aims to highlight the geotourism potential of each geomorphosite by presenting their scientific, scenic/aesthetic, protection, functional and touristic values. The main purpose of this study is to analyse the relationship between the various parameters, such as: the level of knowledge on geoscientific issues, surrounding landscape and nature, level of protection, functional and touristic values of the investigated geomorphosites. The values obtained for the main and additional parameters, by applying the GAM method, allowed the geomorphosites ranking, and highlighted the advantages and problems that will affect the future geotourism development of the studied area.

Keywords: Geoheritage, geotourism, geomorphosites, Pogradec area, GAM method.

INTRODUCTION

In recent geoscientific studies, terms such as geodiversity, geoheritage, georesources, geosites and geotourism are widely used. According to Gray (2013) geodiversity comprises geological, geomorphological landforms, topography, and physical processes, pedological and hydrological features. Various parts of geodiversity which support a better understanding of the Earth history (rocks, fossils, minerals and geological landscapes) are part of the geological heritage or geoheritage (Adriansyah et al. 2015).

The geoheritage includes a wide range of abiotic features and processes, with high scientific, esthetical, educational, protection, cultural, economic, and touristic values. According to Brihla (2020) the *in situ* abiotic elements with scientific value are called geosites, while the ex-situ ones are named geodiversity sites.

Different researchers (Reynard 2005; Reynard & Panizza 2005; Reynard et al. 2007; Panizza & Piacente 2009) defined the geomorphosites as landforms with special attributes, which are all part of the cultural heritage of a given territory. Included in the geomorphosites are the relief landforms (mountains, hills, caves, canyons etc.) formed by erosional processes, lacustrine or riverine sedimentation, glacial and tempestite deposition, karstic, alluvial or deluvial processes, and not at last by anthropogenic activity. They can be simple geomorphological landforms or part of the vast landscape which can be modified, damaged, or changed under the anthropogenic influence. Their real values are unknown for the public, being a necessity to improve their knowledge on such topics.

The geotourism is the field which promotes the geological, geomor-

phological and landscape/scenery characteristics as touristic attraction, this type of tourism is focused on Earth geological features, in promoting their environmental, cultural and protection values (Dowling & Newsome 2006; Newsome & Dowling 2010; Newsome et al. 2012; Dowling 2013). The geotourism offers knowledge on the local geology and allows a better understanding regarding its connection to the natural richness, such as: biodiversity, archaeology and culture (Martini et al. 2012).

